


RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit
MSc në “MENAXHIM BANKAR”
UNIVERSITETI PRIVAT “ALBANIAN UNIVERSITY”

Ekspertëte vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr. Halit XHAFA

Prof.Dr. Shyqyri LLACI



Tetor 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc në "Menaxhim Bankar"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Departamenti përgjegjës	Departamenti i Shkencave Ekonomike
4	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim i KM, Nr.56, datë 21.01.2009
5	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër i MASH, Nr.327, datë 07.08. 2012 VKA Nr. 355, datë 13.07.2012
6	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar"
7	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
8	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
9	Kreditet në total (ECTS):	120
10	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
11	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
12	Programi ofrohet nga institucioni	PO
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
17	Aktivizimi i programit të studimit per here te parë	2010-2011
18	Numri i studentëve aktualë	2016-2017 15 studentë 2017-2018 10 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i shkencave në “Menaxhim Bankar”

HYRJE

Albanian University (AU) është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë, i cili është licencuar në prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2017 ky institucion ka marrë akreditimin institucional 2 vjeçar nga Bordi i Akreditimit

Programi Master i Shkencave në ‘Menaxhim Bankar’ është licencuar me VKM nr. 56, datë 21.01.2009 dhe është akredituar për herë të parë me VKA nr.355, datë 13.07.2012, Urdhër të Ministrit nr. 327, datë 07.08.2012. Tashmë, pas 6 vitesh ka aplikuar për akreditimin periodik.

Në këtë program studimi në vitin 2012-2013 (viti i parë i rivlerësimit në kuadër të akreditimit periodik) të celjes së tij janë regjistruar 48 studentë, ndërsa dy vitet e fundit akademike numri i tyre është ulur ndjeshëm, ç’ka përbën edhe një analizë në këtë RVJ.

Për përpilimin e këtij raporti, GVJ është mbështetur në:

- Shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të AU në të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e zhvillimit të programeve mësimore (rregullore dhe udhëzime, vendime, dosjet e programeve të studimit, regjistrat themeltar, dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, sekretaria mësimore).
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës dy ditore në vend si dhe në intervistimet e studentëve, stafit akademik efektiv dhe me kontratë, stafit administrativ ndihmës, takimet me drejtuesit e institucionit si dhe vizitave në zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e NJSBC, zyrën e kurrikulave, bibliotekë, laborator, etj.

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, përgjegjësin e departamentit të shkencave ekonomike, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të këtij fakulteti të përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi, studentë, punonjësit e sekretarisë mësimore, të zyrës së bibliotekës, të burimeve njerëzore, të NJSBC etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij institucioni, sallën e kompjuterave, sallat e leksioneve/ seminareve, në bibliotekën e fakultetit dhe mjediset e brendshme.

Vlerësimi i programit të studimit u përqëndrua në analizën e programit të studimit, objektivave formuese, kompetencat që fitohen, përputhshmëria e titullit të lëshuar me kurrikulën e ofruar, mënyrën e organizimit të kurrikulës, analizat e syllabuseve (programet e lëndëve), format e veprimtarive formuese për çdo disiplinë, mënyra e organizimit të vlerësimit të dijeve, kompetenca e stafit, literatura e përdorur etj.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Prof.Dr. Halit XHAFA


Prof.Dr. Shyqyri LLACI

Gjatë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm u asistuan nga specialistët e ASCAL, R. Qatipi dhe E. Xhako.

Më datë 18.10.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 7/23 Prot., datë 18.10.2018 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, AU është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 22.10.2018, AU përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 299/1 Prot., datë 22.10.2018, “Kthim përgjigje shkresës Nr. 7/23 Prot., datë 18.10.2018”. Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me komentet dhe japin argumentat si më poshtë:



1. Për komentin e parë në lidhje me literaturën, **nuk ka ndryshime**. GVJ, vlerëson iniciativën e institucionit duke rishikuar syllabuset, ku literatura është e viteve 2013 e në vazhdim, por kjo për syllabuset që do të hyjnë në zbatim, gjatë vitit akademik 2018-2019. Për periudhën për të cilën vlerësohet PS Msc. në “Menaxhim Bankar”, gjendja është sikundër është shprehur në raport.
2. Për komentin e dytë **nuk ka ndryshime**. GVJ vlerëson vendimmarrjen e institucionit për të përfshirë praktikën në kurrikulën që hyn në zbatim për 2018-2019, siç edhe GVJ e ka shprehur në raport, por për vitet për të cilat shtrihet ky vlerësim PS Msc në “Menaxhim Bankar”, nuk ka pasur praktikë.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Programi Master i Shkencave në Menaxhim Bankar u akreditua me Vendim të Këshillit të Akreditimit. Nr. 355 datë 13.07.2012. Sipas këtij vendimi janë bërë këto rekomandime:

- a) Të shtohet numri i stafit akademik me kohë të plotë, me tituj dhe grada shkencore, të angazhuar në programin MSc në Menaxhim Bankar.
- b) Të kryhen studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri.
- c) Të synohet realizimi i auditimit të jashtëm financiar lidhur me programet master, përfshirë programin MSc në Menaxhim Bankar.
- d) Të raportohen në mënyrë më të detajuar treguesit e efikasitetit të shfrytëzimit të fondeve, veçanërisht të përfuara nga tarifat e studentëve në programin MSc në Menaxhim Bankar.
- e) Të sigurohet që studentët e këtyre programeve studimesh duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombetare.

II. Sipas RVB dhe verifikimit në vend nga GVJ, plotësimi i tyre nga Institucioni në mënyrë të përmbledhur paraqitet:


Rekomandimi a

Albanian University ka zbatuar “Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2013 -2017”. Më tej është hartuar “Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022”. Në to, sipas verifikimit në vend të GVJ janë përfshirë çështje si ato për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore; rekrutimin e personelit të kualifikuar shtetit; fonde te vecanta nga Bordi Administrativ për kualifikimin e stafit; punesimi i pedagogëve të rinj drejt kontingjentit cilesor të shkolluarve dhe të të kualifikuarve jashtë vendit duke rritur mekanizmat motivues, përfshirja e stafit në veprimtari kërkimore-shkencore dhe mbështetja institucionale e saj.

Është hartuar plani strategjik i fakultetit dhe plani strategjik i departamentit. Në të dy këto dokumente paraqiten objektivat për rritjen e numrit dhe përmirësimin e cilësisë duke synuar gradat dhe titujt shkencorë për stafin e brendshëm dhe të jashtëm. GVJ konstaton se kjo dukuri është vërtetuar nga viti në vit, dhe në vitin 2017-2018 ka përmirësim të dukshëm në këtë drejtim.

Konkretisht, raporti i personelit akademik efektiv me atë me kontratë në gjashtë vitet e fundit: në vitin akademik 2012-2013 6 PAE dhe 7 PAK, në vitin akademik 2013-2014, 1 PAE dhe 8 PAK, në vitin akademik 2014-2015, 2 PAE dhe 10 PAK, në vitin akademik 2015-2016, 3 PAE dhe 7 PAK, në vitin 2016-2017, 6 PAE dhe 7 PAK, në vitin akademik 2017-2018, 8 PAE dhe 4 PAK

Ky rekomandim është përmbushur.




Rekomandimi b:

Departamenti i Shkencave Ekonomike realizoi ne muajin korrik 2016 raportin 'Studimi i tregut të punës për të diplomuarit'.

Universiteti nga tetori 2017 është pjesë e projektit "GRADUA", projektit Erasmus +, KA2, dhe në përfundim të implementimit do të prodhojë të dhëna të detajuara për të diplomuarit, vit pas viti në shkallë vendi.

Sidoqoftë GVJ gjykon se ende ka nevojë për përsosje dhe thellime studimi i tregut i realizuar sidomos në krahun e kërkesës që ofrojnë bizneset në përgjithësi dhe vecanërisht institucionet financiare dhe bankare për specialist bankarë dhe të kualifikimeve të larta të cilave iu drejtohet programi Msc në "Menaxhim Bankar".

Ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.

Rekomandimi c:

Në AU janë kryer auditime të jashtme të përvitshme nga auditues të pavarur, ku paraqiten ndarja e shpenzimeve sipas kategorive kryesore të programit master; paga, qera, shpenzime administrative, shpenzime për kërkim-zhvillim si botime, konferenca, akomodime te lektoreve të huaj, etj. Periudha ushtrimore mbyllet ne daten 31 Dhjetor te vitit pasardhes.

Lipset që të ndërtohet një sistem sa më i drejtë i ndarjes së shpenzimeve fikse sipas programeve, pasi kjo kontribuon në përcaktimin e saktë të kostos së cdo programi dhe mbi këtë bazë të kostos dhe të ardhurave dhe për rjedhojë dhe rentabilitetit për cdo program.

Ky rekomandim është përmbushur kryesisht

Rekomandimi d

Rekomandimi i mësipërm kontribuon më drejtpërdrejt edhe në rekomandimin që lidhet me treguesit e efencës së shfrytëzimit të fondeve, vecanërisht të përfuara nga tarifat e studentëve në programin MSc në Menaxhim Bankar. Albanian University ndjek nje politike te hapur dhe transparente ne lidhje me shperndarjen e burimeve financiare.

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Buxheti i dhënë për cdo vit akademik miratohet në kohën e duhur. Ky buxhet ndërtohet mbështetur në nevojat që paraqet cdo departament për kancelari, mirëmbajtje, furnizime të reja, tekste mesimore, investime etj. Fakulteti ka bërë shperndarjen e fondeve të përfuara nga tarifat e studentëve për programet "Master i Shkencave":

Nr.	Emërtimi	Ne %
A	Të ardhurat	100%
	Nga tarifa e studentit	100%
	Nga veprimtari shkencore	
<u>B</u>	<u>Shpenzime, mësimdhënie dhe shkencë</u>	80%
1	Fondi i pagave (a+b)	60%
a	Për paga-bazë	22%
b	Honorar për orët e mësimin	38%
2	Fondi i Ekselencës	2%
3	Kosto të tjera të departamentit	9%
4	Personel Administrativ	9%
<u>C</u>	<u>Investime</u>	5%
<u>D</u>	<u>Fitimi bruto A-(B+C)</u>	15%

Eficienta dhe mirëadministrimi i këtyre fondeve kontrollohet vit pas viti nga auditori i brendshëm dhe i jashtëm i AU.

Lipset të ndërtohet një numër treguesish efience, sipas programeve, ku krahas tarifave të studentëve që janë qartësisht të lexueshme sipas programeve, kërkohet të ndërtohen ndarja e shpenzimeve fikse dhe atyre të ndryshueshme sipas programeve, kjo për faktin se stafi i këtij programi është staf edhe i programeve të tjera dhe infrastruktura e këtij programi është edhe e programeve të tjera. AU ka kapacitete ta ndërtojë këtë sistem që do rrisë ndjeshëm menaxhimin dhe leximin e eficiencës për çdo program


Ky rekomandim është përmbushur pjesërisht

Rekomandimi e

Studentet e diplomuar në programet e studimit “Master i Shkencave në Menaxhim Bankar” para tërheqjes së kartonit të diplomës kanë dhënë provimin e gjuhës angleze në teste ndërkombëtare të njohura nga MASR, kopja e së cilës gjendet në dosjen e studentit.

Nga viti 2015 me Udhezim të Ministrit nr. 52, datë 03.12.2015 mbrojtja e njëjës prej pesë gjuhëve evropiane në nivel B1 është kriter hyrës për programet ‘Master i Shkencave’.

Ky rekomandim është përmbushur



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike kanë hartuar strategji afat shkurtër dhe afat mesëm të koordinuara me njëra tjetrën. Në to krahas të tjerave janë caktuar edhe objektivat për masterat e shkencave që ofron Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Nga RVB, misioni dhe objektivat e programit të studimit janë [citojmë]:

Programi Master i Shkencave në Menaxhim Bankar i ofruar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike siguron një zhvillim bashkëkohor dhe akademik të orientuar drejt praktikës dhe një profesionalizëm të qëndrueshëm.

Misioni i programit është përgatitja e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat dhe specifikisht në sektorin financiar (Banka Qendrore e Banka të nivelit të dytë), në sektorin publik dhe organizata jo-fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor.

Programi është strukturuar për të edukuar studentët me njohuritë bazë në fushat e menaxhimit të financave të një entiteti apo financave publike, administrimit të financave lokale, njohuri të cilat do i ndihmojnë ata të mendojnë në mënyrë analitike dhe kritike në menaxhimin e fondeve dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme ekonomike me anën e njohurive të fituara.

Misioni i programit është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të AU, me standardet ndërkombëtare, si edhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë. Qëllimi i programit është studimi i kombinuar i metodave dhe formave bashkëkohore të analizës e menaxhimit financiar duke u pajisur edhe me njohuri rreth modeleve të analizave financiare për përdorimin e këtyre dijeve në të gjitha nivelet e menaxhimit financiar si dhe në të gjitha fushat e ekonomisë dhe biznesit. Programi studion dhe punon me bashkëveprimin midis teorive dhe teknikave më të zhvilluara të shkencës së administrimit e menaxhimit financiar, biznesit dhe shoqërisë. Lëndët bazë do të ofrojnë njohuri në mbështetjen dhe zgjerimin e menaxhimit, ndërsa lëndët e fushës do të ofrojnë njohuri funksionale bankare. Pjesëmarrësit do të përfitojnë një edukim në fushën e menaxhimit akademik dhe teorik dhe përdorimit të këtyre teorive e metodave me anë të një programi intensiv që balancon teorinë më novatore të biznesit me studimin e tregut bankar dhe të punës në grup për të arritur në zgjidhje krijuese në sfidat e botës reale. Programi fokusohet në konceptin "si të mendojmë për të arritur efikasitet e efikasitet maksimale të kapitalit financiar" më tepër sesa "çfarë të mendojmë". Qëllimi i programit është t'u ofrojë studentëve qasjet strategjike të nevojshme për të arritur sukses në fushën e menaxhimit bankar.

Programi i pajis studentët me aftësi analitike dhe prognozë për optimizimin dhe arritjen e vlerave maksimale të dobishmërisë së inputeve financiare në një organizatë. Kjo përfshin të kuptuarit se si kombinohen inputet humane me ato financiare dhe se si funksionojnë financat e një organizate. Programi i referohet edhe përdorimit të mjeteve të menaxhimit të informacionit për përpunimin, ruajtjen, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave financiare që lidhen me biznesin, duke lehtësuar analizat që përdoren për të kuptuar këtë informacion. Programi plotëson një nevojë të madhe aktuale për profesionistë në fushën e menaxhimit bankar me aftësi në të gjitha nivelet e menaxhimit financiar dhe të institucioneve financiare shtetërore.

Objekivi kryesor i programit është transmetimi i njohurive gjithëpërfshirëse mbi mënyrat e menaxhimit të kapitalit financiar për bizneset, administrimin, organizimin, vendimmarrjen dhe marketingun modern të produkteve bankare duke bërë të mundur formalizimin e ekonomisë dhe edukimin financiar të brezit të ri të drejtuesve të biznesit.

Objektivat specifikë të programit janë:

1. Mundësimi i përfitimit të aftësive praktike për të kuptuar rolin që sistemi i menaxhimit ka në një treg financiar e në sektorin bankar;
2. Mësimi i aplikimit të koncepteve të fituara të sistemeve bashkëkohore në menaxhim e riskut financiar në problemet e biznesit;
3. Fitimi i aftësisë të të punuarit që në situata të ndryshme kërkojnë optimizim nëpërmjet menaxhimit brenda një biznesi;
4. Të kuptuarit e rolit që luajnë menaxheret e niveleve të ndryshme në fushën e tregjeve financiare;
5. Të kuptuarit thelbësor të koncepteve menaxheriale dhe mënyrave si mund të aplikohen ato në sistemin bankar;
6. Fitimi i aftësisë për të zhvilluar analizë të ndryshimeve menaxheriale dhe riskut të rrjedhur prej tyre në proceset e biznesit;
7. Të ofrojë njohuri klasike nga fusha e menaxhimit të produkteve bankare dhe të rrisë përdorimin praktik të këtyre produkteve;

Programi synon përgatitjen e specialistëve në sektorin bankar, Banka Qendrore e Banka të nivelit të dytë, në sektorin publik dhe organizata jo-fitimprurese, dhe biznese private duke siguruar një arsimim të gjërë profesional dhe shkencor. Nëse shohim këtë objektiv dhe kurrikulat e programit, shohim që pak ka disiplina të orientuara drejt biznesit privat, drejt sektorit publik, organizatave jo fitim prurëse, pra synimet strategjike dhe programit të fokusuar në menaxhimin bankar, kanë diferencë.

Sipas RBV programi plotëson një nevojë të madhe aktuale për profesionistë në fushën e menaxhimit bankar me aftësi në të gjitha nivelet e menaxhimit financiar dhe të institucioneve financiare shtetërore. Programi është hartuar që t'i përgjigjet kërkesës së tregut për drejtues të sistemit bankar, të biznesit privat në sektorin e financave në institucione të ndryshme financiare, drejtues departamentesh finance në korporatat kombëtare e ndërkombëtare, punonjës të administratës lokale e qendrore për probleme financiare, etj.

GVJ gjykon se shkalla e nevojës përcaktohet nga tregu që është e paidentifikuar si duhet kur ky program apo të ngjashme me të ofrohen në një sërë Universitetesh Publike dhe Jo Publike në vend, pra është studimi i tregut ai që e përcakton këtë. Po ashtu syllabuset e paraqitura dhe plani mësimor, nuk e garantojnë këtë objektiv për të gjitha nivelet sic edhe pretendohet.

Sipas RVB, objektivi kryesor i programit është transmetimi i njohurive gjithëpërfshirëse mbi mënyrat e menaxhimit të kapitalit financiar për bizneset, administrimin, organizimin, vendimmarrjen dhe marketingun modern të produkteve bankare duke bërë të mundur formalizmin e ekonomisë dhe edukimin financiar të brezit të ri të drejtuesve të biznesit.

GVJ gjykon se fushat që synon programi janë me ndryshime të dukshme midis tyre dhe një program i specifikuar dhe i fokusuar në menaxhimin bankar sic edhe është emërtuar nuk mund të realizojë këtë diapazon kaq të gjërë të synuar përputhshmëria e titullit të lëshuar me kurrikulën e ofruar.

Programi është ndërtuar sipas Kartës së Bolonjës, "Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve" (ECTS) i cili mundeson transferimin e krediteve në Universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit dhe anasjelltas. Janë ndërtuar edhe objektiva strategjike të departamentit të shkencave ekonomike ku synohet:

1. Rishikimi i teksteve bazë dhe përditësimi i literaturës plotësuese;
2. Rishikimi i syllabuseve të lëndëve (deri 20% ndryshim) dhe i ngarkesave mësimore;
3. Vëzhgim i cilësisë në procesin e mësimdhënies;
4. Krijimi i lidhjeve dhe marrëveshjeve me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare;
5. Përditësimi i programeve mësimore dhe kërkimit shkencor sipas nevojave të tregut;

6. Ndërtimi i një qendre shkencore në fushat ekonomike;

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>AU si institucion i AL, ka hartuar strategji institucionale dhe të vecanta sipas fakulteteve dhe departamenteve. Në linja kryesore objektivat strategjike, misioni dhe qëllimet e tyre janë të harmonizuara.</p> <p>Programet kanë synuar tregun e punës, për këtë është bërë dhe një studim tregu në vitin 2006 dhe synohet një tjetër në vazhdim me një projekt Erasmus që do saktësojë nevojat e tregut sidomos përsa i përket numrit të diplomuarve.</p> <p>Synim i programit është ndjekja e zhvillimit ekonomik të vendit. <i>Në këtë drejtim studimi i tregut i realizuar fokusohet kryesisht në kontigjentet që diplomohet dhe jo në evolucionin e kërkesave të tregut specifik të këtij programi si sistemi bankar, institucionet financiare jo bankare, sektori publik, apo bizneset private.</i></p> <p>Programi është në përputhje me objektivi strategjik të Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional ‘2017-2022’ me synim aftësimin e studentëve me njohuri, dhe kompetenca profesionale për të qënë të aftë dhe të suksesshëm në tregun e punës.</p> <p><i>Sipas RVB, ky program ka lënde të cilat përkohjnë me perspektiven e zhvillimit ekonomik të vendit sip.sh. lendet “Menaxhim Fiskal”, “Auditimi i institucioneve Financiare” apo lenda “Financat e Korporatave” që është kaq e nevojshme për të pajisur menaxherët e rinj që do të punësohen në tregun kombëtar apo rajonal.</i></p> <p><i>Sic shihet janë tre fusha të ndryshme, larg njera tjetrës që dallojnë nga vetë emërtimi i programit ‘menaxhim banke’, pra në vend të fokusimit, shpërndahe në sektorë të ndryshëm nga sistemi financiar. Ka një dallim midis emërimit të programit, objektiveve të programit dhe lëndëve të planit mësimor.</i></p> <p>Programi nuk bie ndesh me vlerat kulturore Kombëtare.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>AU ka hartuar strategji zhvillimi si institucion, si fakultete dhe departamente. Ajo si institucion është publikuar në faqen web ‘Planin Strategjik për Zhvillim Institucional 2017-2022’.</p> <p>http://albanianuniversity.edu.al/sq/strategjia-ezhvillimit-institucional/</p> <p>Programi Master i Shkencave në Menaxhim Bankar është në akord dhe mbështetje të strategjisë së institucionit.</p>

Standardi L3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi MSc në Menaxhim Bankar dhe diploma e tij janë hartuar mbështetur në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Departamenti ka hartuar rregullore të vecantë për programin master i Shkencave në Menxhimin bankar ku trajtohet objektivat, misioni, qëllimet kriteret e pranimit, objektiva mbi syllabuset, etj. Kurrikula dhe syllabuset janë hartuar sipas udhëzimeve të MASR.</p> <p>Emertimi i programit “Master i Shkencave në Menaxhim Bankar” është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
Standardi L.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar ‘Planin Strategjik ‘2017-2022’, ku janë vendosur objektivat e zhvillimit të institucionit, pjesë e së cilës është edhe zhvillimi i fakultetit dhe departamentit që ofron programin në shqyrtim.</p> <p>Sipas vizitës në institucion, konstatuam se janë bërë përditësime të syllabuseve dhe përgjithsisht edhe të literatures së përfshirë në Pjesë e planit të zhvillimit strategjik janë edhe objektivat konkrete të zhvillimit për periudhës 2017 - 2022 që synojnë përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke pasuruar mesimdhënien me leksione të hapura nga eksperte vendas e të huaj.</p> <p>Objektiv është edhe rritja e punës shkencore dhe nivelit shkencor të stafit dhe e nivelit shkencor të procesit mësimor, student dhe pedagogë.</p>
<p>Konkluzionet e vleresimit:</p> <p>GVJ arrin në përfundimin se programi MSc në Menaxhim Bankar ofrohet brënda strategjisë dhe misionit të institucionit, me aktet ligjore në fuqi, me respektimin e vlerave kulturore dhe nivelit të studimeve në ciklin e dytë.</p> <p>Ajo që konstatohet është se midis objektivave të programit dhe syllabuseve dhe planit mësimor të hartuar ka diferenca në shtrirjen në gjërësi dhe thellësi. Ka një fokus më të përcaktuar të titullimit të programit, që është sistemi bankar dhe deri diku dhe sektori financiar, me objektivat e shprehura se i drejtohet edhe sektorit publik, sektorit privat, organizatave jo fitim prurëse, etj, që e gjejnë veten pak në program. Prandaj lipset të bëhen ndryshimet dhe rakordimet e nevojshme të objektivave dhe fokusit të këtij programi me planin mësimor dhe kualifikimit shkencor e profesional që ai realisht ofron.</p> <p><u>GVJ gjykon se standardet përmbushen kryesisht</u></p> <p><u>Rekomandime:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ gjykon se Misioni dhe Objektivat e këtij programi studimi Master i shkencave në “Menaxhim Bankar” sic edhe është emërtuar duhet të rishikohen që të mund të përputhet me titullin e Diplomës.</i> 	

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi Msc MB ka patur evoluimin e tij përsa i përket strukturave që e kanë ofruar. Në periudhën 2009-2010 është ofruar nga departamenti i Financë-Bankës, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Në periudhën 2010-2014 është ofruar nga departamenti i Financë-Bankës pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Në periudhën 2015-vazhdim nga departamenti i Shkencave Ekonomike pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. pas riorganizimit të Universitetit në tre Fakultete sipas VKA nr. 117, datë 18.12.2015, Urdhërit të Ministrit Arsimit nr. 52, datë 05.02.2016.

Njësitë bazë mësimore-shkencore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike janë:

- Departamenti i Shkencave Ekonomike.
- Departamenti i Arkitekturës,
- Departamenti i Inxhinierive,

Fakulteti ka edhe struktura administrative dhe ndihmëse që përbëhen nga Sekretaria Mësimore, Personeli ndihmës- akademik, të cilat ishin pjesë e axhendës të GVJ gjatë vizitës në institucion.

Departamenti i Shkencave Ekonomike koordinon mësimdhënien me njësitë e tjera, në veçanti me departamentet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës.

Departamenti është organizuar në grup lëndë që ofrohen në shkallë fakulteti dhe universiteti. Grup lëndet janë: të formimit bazë, menaxhim; financë-kontabilitet, ekonomiks dhe statistikë- matematikë. Drejtuesit e grup lëndëve janë pedagogë me grada dhe tituj shkencorë dhe me eksperiencë administrative dhe kapacitete shkencore.

GVJ referuar kësaj strukture, mendon se kjo strukturë është në funksion të programit të studimit, të përmbushjes së objektivave si dhe të implementimit të strategjisë që institucioni, ka për këtë programi studimi

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Sipas RVB, personeli akademik sipas njësive bazë të Institucionit ku përfshihet edhe Departamenti i Shkencave Ekonomike, me tituj e grada, PAE dhe PAK paraqitet në Tabelën 1 (Anekse)

Departamenti i Shkencave Ekonomike, ka ardhur duke u rritur me staf të brëndshëm dhe jashtëm, me tituj e grada shkencore (Tabela 2) ne Anekse

Për vitin akademik 2017-2018 ky departament në dispozicion të programit Msc Menaxhim Bankar ka vënë në dispozicion:

- 28 pedagogë të brëndshëm: 1 profesor, 4 profesorë të asociuar, 11 doktorë shkencash, 3 doktorë në proces dhe 9 me Msc.
- 23 pedagogë të jashtëm: 3 profesorë, 9 profesorë të asociuar, 5 doktorë shkencash, 1 docent, 5 me Msc. Përgjithsisht pedagogët e jashtëm, të ftuar janë mësimdhënës në institucione të tjera të arsimit të lartë publik ose jo publik.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion.

Nga vizita në institucion GVJ vëzhgoi edhe dosjet e c vetëvlerësimit të pedagogëve, ku rrreshtohen të gjithë kontributet dhe aktiviteti i tyre vjetor, mesimdhënie, punë jashtë auditorit, ndjekje praktikash, konsultime për temat e diplomave, punë shkencore, pjesmarrja në konferenca, punë në dobi të fakultetit, etj. Të gjitha

këto janë saksionuar edhe në kontratat individuale midis punëdhënësit, rektorit të AU dhe punëmarrësit, pedagogut efektiv me kontratë. Në dosjen e përbashkët është edhe vlerësimi i përgjegjësit të departamentit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Sipas organigramës në dosjen e institucionit AU, struktura organizative AU është ndërtuar në funksion të qëllimeve, misionit dhe të ofrojë më eficiencë dhe nivel programet e licensuara dhe akredituara.</p> <p>Universiteti përbëhet nga tre njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike me tre njësi bazë: Departamenti i Shkencave Ekonomike; Departamenti i Inxhinierive dhe Departamenti i Arkitekturës; 2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore me katër njësi bazë: Departamenti i Shkencave Juridike, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. 3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore me tre njësi bazë: Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë <p>Departamenti i Shkencave Ekonomike ka 23 anëtarë të personelit akademik efektiv, ndër të cilët 1 Profesor, 4 Profesorë të Asociuar, 8 Doktorë, 2 Doktorë në proces dhe 8 asistentë lektorë (Tabela 1 dhe 1.1).</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me një sërë strategjish dhe rregulloresh që janë edhe pjesë e dosjes së aplikimit. Institucioni, njësia kryesore, njësia bazë kanë hartuar rregulloren e tyre, po ashtu edhe programi MSc në 'Menaxhim Bankar'. Këto janë të interferuara dhe ndërthurura me rregulloren e institucionit.</p> <p>Përgjegjësitë e njësive bazë dhe kryesore janë të mirë përcaktuara në rregulloren e funksionimit të Departamentit në rregulloren e në rregulloren e institucionit dhe statut.</p> <p>Nevojat për rekrutime të stafit me kohë të plotë dhe të pjesëshme burojnë nga nevojat e procesit mësimor. Pra njësia bazë, mbështetur në fondin e orëve që duhet të ofrojë, fushat përkatëse, në të gjitha programet brënda dhe jashtë fakultetit, dhe stafin aktual dhe ngarkesat specifike mësimore dhe shkencore të gjithsecilit përcakton nevojat për staf të ri me kohë të plotë e të pjesëshme por edhe disa kërkesa specifike që bëhen pjesë e kriterëve që shpallen më tej. Në periudhën korrik-shtator i kanë paraqitur Dekanit dhe ky i fundit</p>

	<p>Rektorit, kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Dekani ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, i cili ka përcaktuar kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit.</p> <p>Sic u verifikua në vizitën në institucion, njoftimet për vende të lira pune janë paraqitur në faqen web të institucionit. http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>AU është organizuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Sic u pa gjatë vizitës në institucion, ka një set të plotë aktesh ligjore bazë mbi të vilat janë hartuar e miratuar statuti institucionit, strategjia e zhvillimit institucional, i njësisë kryesore, i njësisë bazë dhe i programit Msc Menaxhim bankar, të cilat janë të ndërthuara dhe integruara tek njëra tjetra.</p> <p>AU ka numrin e fakulteteve sipas ligjit, Fakultetet, numrin e departamenteve dhe departamentet stafin me kohe të plotë e pjesëshme me tituj e grada shkencore.</p> <p>Për programin Msc Menaxhim Bankar është angazhuar njësi bazë me staf, programe, mësimdhënie, ndjekje administrative e shkencore.</p> <p>GVJ konstaton se është ndërtuar një sistem i përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik, por edhe atij ndihmës akademik mbi kriteret të matëshme dhe të vlerësueshme dhe përgjithësisht është zbatuar.</p> <p><u>GVJ gjykon se këto standarde përmbushen.</u></p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore



Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Për realizimin e programit Master i Shkencave Menaxhim Bankar, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si njësi kryesore dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike si njësi bazë, ka angazhuar një numër të qënësishëm stafi me kohë të plotë dhe të pjesëshme dhe personeli ndihmës mbështetës të programit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për infrastrukturën. Këto verifikohen nga dosja e paraqitur, RVB dhe vizita në institucion.

Për t'u shënuar është rritja e numrit të stafit me kohë të plotë dhe stafit me kohë të pjesëshme nga viti në vit, gjë që ka cuar në një lloj specializimi të pedagogëve sipas disiplinave që mbulojnë, rritjen e konsultimit dhe bashkëpunimit midis lëndëve dhe gruplëndëve, rritjen e sasisë dhe cilësisë së shërbim mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara nga Universiteti, dhe sipas standardeve shtetërore të cilësisë.

Eshtë rritur dhe përmirësuar edhe larmia e kontributeve të cdo pedgogu, e punës mësimore, shkencore, ndjekje të praktikave mësimore, në cilësinë e përgatitjes së diplomave, në punë dhe aktivitete në shërbim të departamentit, fakultetit dhe institucionit në tërësi.

Ka ardhur drejt përmirësimit dhe konsolidimit edhe procedura e rekrutimit të stafit të ri duke filluar nga përcaktimi i nevojave për këtë staf deri në përzgjedhjen përfundimtare, kontraktimin e tij, dhe pse jo edhe në vazhdimësi për realizimin e cdo rubrike të kontratës nga institucioni dhe pedagogu i punësuar.

Kërkesat për staf të ri identifikohen nga plani dhe programi mësimor për cdo vit akademik, numri i orëve ne auditor dhe jashte tij dhe nevojat për kërkim shkencor, normat e ngarkesës për cdo pedagog, nevoja për rritjen e nivelit shkencor, raportet staf i brëndshëm staf i jashtëm, etj. Mbi këto parametra, e të tjera të nevojshme përcaktohet nevoja për staf të ri nga departamenti si njësi bazë, i përcillen keto kërkesa dekanatit e më tej rektoratit duke u shoqëruar edhe me projekt kriteret e rekrutimit, ku shënohet fusha, kualifikimi i kandidatit, grada apo titulli shkencor që preferohet të afrohet, e kushte të tjera specifike. E gjithë kjo procedurë realizohet në fillim të cdo viti akademik.

Sipas RVB dhe verifikimit në institucion në Burimet Njerëzore, vendet e punës për personelin akademik në AU fitohen nëpërmjet një procedure konkurruese. Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 muaj në mbarim të së cilës përcaktohet nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe universitetit rregullohet nga kontrata e punës, mbështetur ne Kodin e Punës, dhe në respektim të Legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë

Kriteret kryesore sipas vizitës në institucion, janë cikli i dytë i studimeve sipas lëndës që do mbulojë kandidatit, mesatarja mbi 8, grada doktor ose PhD, eksperiencia në mësimdhënie e lidhur me lëndën që do të mbulojë, zotërimi i gjuhëve të huaja, aftësi për mësimdhënie.

Krahas rritjes sasiore dhe cilësore të stafit të departamentit të shkencave ekonomike në tërësi relatuar në rubrikën paraardhëse, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për stafin e angazhuar drejtpërdrejt në programin Msc Menaxhim Bankar.

Kështu raporti PAE/PAK që nga koha e fillimit të këtij programi viti 2012-2013 deri në vitin 2017-2018 luhet nga 6/7 në vitin e parë në 8/4 aktualisht, duke u shoqëruar edhe me rritje edhe të fondit të orëve që mbulon PAE në 72 përqind të fondit të orëve gjithsej të programit, pa përmendur rritjen cilësore të mësimdhënies, si përmirësimet në planin mësimor, në syllabuse, në metodën e mësimdhënies e mësimnxënies, në insrastrukturën enë dispozicion të programit,etj. Na duket i pajustificuar ky raport në vitet 2013-2014 deri 2015-2016 ku dominohet nga pedagogë të jashtëm ndërkohë që në këto vite edhe kontigjentet e studentëve kanë qënë relativisht të mëdha. Sidoqoftë tashmë është problem i tejkaluar.

Në nivele të arsyeshme është vërtetuar edhe raporti Personel akademik/Personel administrativ/studentë të vitit të parë që deri në vitin 2015-2016 ka qënë në parametrat respektivë 13/9/48 e që zbrit ndjeshëm dy vitet e fundit, dhe në 2016-2017 arrin në 12/9/13. Kjo për shkak të rënies së ndjeshme të numrit të studentëve. Sipas viteve të funksionimit të programit ky raport paraqitet:

2012 – 2013	13/9/48
2013 – 2014	9/9/60
2014 – 2015	12/9/57
2015 – 2016	10/9/32
2016 – 2017	13/9/15
2017 – 2018	12/9/13

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nëse në vitin e parë deri të katërt të programit ka patur një doktor shkencash PAE dhe 3-4 me grada e tituj staf të jashtëm dy vitet e fundit ky raport e përbërje ka përmirësim të ndjeshëm (shih tabelat 3.1 deri 3.5 në pasqyrat anekse)

Evoluim sasior dhe cilësor vërtetohet edhe në raportet midis pedagogëve me grada e tituj ndaj atyre gjithsej si të brëndshëm edhe të jashtëm, të raporteve sipas gjinive, të ngushtimit të moshave nga nivete skajore në fillimet e programit në një rritje graduale drejt moshës së mesme të stafit, kjo për faktin e përfshirjes nv program të pedagogëve me tituj e grada. Në mënyrë të hollësishme sipas viteve këto paraqiten në tabelat 4.1 deri 4.6 dhe tabelat 5.1 deri 5.6 anekse të këtij raporti.

Nëse në vitin e parë të programit kishte si PAE 1 doktor shkencash dhe 3 doktorë shkencash në proces, në vitin 2017-2018 ka patur 1 profesor, 2 profesorë të asociuar, 5 doktorë shkencash.

Ndërkohë ndryshe është situata për PAK, ku nga 3 profesore, 2 doktorë shkencash, 2 doktorë në proces, në vitin 2017-2018 ka 1 profesor dhe 3 doktorë shkencash. Personeli administrativ 9 persona ka mbetur i pandryshuar. Kjo shpjegohet me faktin se për arsye kostosh dhe mundësishë në treg, ishte me lehtë të akomodoheshin në program PAK, gjë që në përmbushje të objektivave strategjike të institucionit, njësisë kryesore, dhe njësisë bazë është përmirësuar drejt PAE.

Lidhur me raportet gjinore M/F, GVJ, mbështetur në të dhënat e paraqitura në RVB nga njësia bazë, në anekset ,sipas viteve të programit Msc Menaxhim Bankar, i rigrupoi ato. Edhe në drejtim të raporteve gjinore luhatjet sipas viteve kanë shkuar drejt një aporti më të pranueshëm në vitin 2017-2018.

Vihet re nga viti një spostim i moshës nga 25-39 në fillimet e programit kryesisht për stafin e brëndshëm në moshat 36-45 dhe 45-55 ndërsa stafi PAK ka një stabilitet relativ të moshës dhe kjo lidhet me faktin se ky staf është relativisht me i disponueshem në treg dhe përzgjedhja e rekrutimi i tij është më e lehtë se në stafin PAE, ku edhe progresi akademik kërkon kohën e tij. Këtë e vertetojnë edhe Tabelat 5, pjesë e RVB, ku ndërsa personeli administrativ është kryesisht i moshës 25-35 ka një spostim të moshës drejt moshave të mesme.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se stafi akademik efektiv dhe me kohë të pjesëshme dhe ai ndihmës i rregullojnë marrëdhëniet me punëdhënësin AU me kontrata te cilat janë të specifikuara me palët e kontratës, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit, afatin, kushtet specifike, penalitetet të gjitha të referuara bazës ligjore qe rregullon marrëdhëniet e punës. Tipikisht janë respektuar afatet që përcakton ligji arsimit të lartë përse i përket afateve, me afat një vjecar ose kohë të pacaktuar varësisht nga grada dhe titujt.

Në kontratë specifikohen detyrimet dhe ngarkesa mësimore dhe disa objektiva të punës shkencorepër personelin që rekrutohet.

Këto detyrime reflektohen edhe në raportin e vetevlerësimit ku ballafaqohen detyrimet për cdo pjesëtar të stafit me ato të përcaktuara në departament për tregues të matshëm si ngarkesa mësimore, në auditor dhe jashtë tij, elementë specifikë të ngarkesës, praktikat e puna me diplomës, artikuj apo pjesmarrja në konferenca dhe elementë të tjerë që ndikojnë në progresin akademik dhe shkencor të të punësuarit.Stafi i rekrutuar me konkurim fitues, njihet me te drejtat dhe detyrat në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe një kopje e kontratës mbahet në institucion Burimet njerëzore dhe tjetra i jepet punëmarrësit, anëtarëve të stafit.

Stafi ndihmës rekrutohet me afat dhe ka të përcaktuara si detyrime fushën që do mbulojë dhe do mbështesë, të drejtat dhe detyrimet e tij. Cilësia e tij vlerësohet nga departamenti por në mënyrë më specifike nga pjesa administrative me drejtues të së cilës ka kontraktuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	GVJ sic u verifikua gjatë vizitës në institucion por edhe nga shikimi i dosjes dhe RVB, konstaton se në procesin e rekrutimit dhe të angazhimit të stafit PAE dhe PAK, është angazhuar staf në përputhje me nevojat por me kualifikim të gjërë brënda fushës, por përgjithësisht edhe me kualifikim të ngushtë dhe nga viti në vit kjo ka ardhur duke u stabilizuar. Nga viti në vit
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

	<p>është shtuar stafi PAE me grada e tituj dhe kjo ka mundësuar edhe krijimin e gruplëndëve që ka rritur bashkëpunimin, shkallën e ekspertizës akademike dhe shkencore.</p> <p>E gjitha kjo përkon edhe me strategjinë e institucionit dhe planet dhe programet e zhvillimit të njësisë kryesore dhe jesisë bazë dhe është edhe pjesë e tyre.</p> <p>Për rregullimin e procesit mësimor, detyrimeve dhe përgjegjësi të pedagogut dhe grup lëndëve dhe tërësive specifike që rregullojnë këtë zbatohen dy rregullore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rregullore e Departamentit të Shkencave Ekonomike; Rregullore e programit të studimit MSc në Menaxhim Bankar <p>Personeli i angazhuar në respekt të rregulloreve dhe kërkesave ligjore, krahas cv që është patur parasysh në procesin e rekrutimit, përgatitit dhe miraton syllabuset e nevojshme që kanë ardhur duke u pasuruar me problematikën e trajtuar dhe literaturën përkatëse. Kjo edhe falë eksperiencës së fituar në procesin mësimor nga viti</p>
--	---

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kurrikulat janë hartuar nga pedagogu i lëndës apo edhe nga grup lënda përkatëse, janë pasuruar nga viti në vit mbështetur edhe në udhëzimet që edhe ato kanë ardhur duke u përmirësuar, janë formatuar sipas kërkesave standarte me objektivat e lëndës, mënyrën e mësimdhënies, detyrimet dhe të drejtat e studentit, mënyra e kontrollit të dijeve, ceshtjet e lëndës, literatura bazë dhe ndihmëse, etj.

Në respekt të lirisë akademike, hera herës janë bërë përsosje e ndryshime deri në kufirin ligjor prej 20 %,



Syllabuset e cdo lënde, nga departamenti dhe fakulteti kalojnë për miratim në senatin akademik që i jep formën e detyrueshme ligjore dhe standardizon në formë hartimin e kurrikulave.

Ai është pjesë e të gjitha vendimeve institucionale në lidhje me evoluimin dhe përmirësimin e programit të studimit.

Bëhen diskutime në departament, sipas rastit, edhe në mbledhjet e pedagogëve, Sipas RVB dhe dokumentacionit që na u paraqit në institucion ato realizohen dy herë në muaj. Kështu është saknionuar në rregulloren e departamentit.

Çdo titullar lënde rishikon syllabuset e lëndëve sipas planit mësimor dhe propozon ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e lëndës në aspektin e mësimdhënies dhe literaturës së sugjeruar.

Rishikimi dhe diskutimi bëhen me grup pune ngritur nga departamenti, me anëtarë të sigurimit të cilësisë të departamentit. Ndryshimet propozohet tek dekani, bëhet më tej vlerësim teknik nga zyra e curiculave, dhe procedura më tej






	<p>ndjek komisionin e zhvillimit të curriculave dhe nga ky pas ndonjerregullimi apo filtrimi të mundshëm i përcillen Senatit Akademik për miratim perfundimtar. E gjithë procedura është pjesë e rregullores së funksionimit të Programit të studimit Msc Menaxhim Bankar.</p> <p>Në rekrutimin e personelit dhe në ngarkesën mësimore zbatohet baza ligjore në fuqi, të ri, Udhëzimi nr.20 dt. 09.05.2008, Udhëzimit nr.40, dt. 08.12.2009 të Ministrisë Arsimit, dhe kërkesat specifike të rregulloreve e që reflektohen në formë të drejtash e detyrimesh edhe në kontratën e rekrutimit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion u muar kontakt me grup të rastësishëm të studentëve dhe u kontrolluar disa regjistra për zhvillimin e mësimin nga ku u konstatua:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Nuk kishte dijeni për titujt e disa lëndëve, të temave që përmbante lenda, të emrave të pedagogëve që e kanë zhvilluar lëndën dhe të materialeve me të cilat është zhvilluar lenda.</i> - <i>Në disa lende, pedagogu mjaftohej me materiale në .ppt po edhe disa shënime duke reduktuar në maksimum materialin mësimor.</i> - <i>Në regjistrat thuajse nuk figuronin mungesa në disa lëndë dhe në ndonjë prej tyre mbi 50 përqind e studentëve kishte mungesa, pra nga pedagogë të ndryshëm përdoren standarde të ndryshme dhe zbatim i ndryshëm i rregulloreve.</i> <p><i>Konstatimet e mësipërme të cojnë në arsyetimin se kërkohet vlerësim real dhe administrativ i frekuentimit dhe pjesmarrjes në mësim, për të cilat ka edhe pikë vlerësuese, kjo do e cojë në vlerësim real dhe jo mesatarizues të studentit, do rrisë përgjegjësinë e pedagogut për t'i administruar dhe diferencuar studentët mbi këtë kriter.</i></p> <p><i>Ndonse pretendimi i studentëve mund të jetë për sa më pak material për komoditet, kërkohet të futet gradualisht frymë më serioze për materialet që ofrohen, për të cilat edhe biblioteka sidomos me botime në shqip kërkohet të pasurohet.</i></p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit janë transparente dhe konkurimi është i hapur. Sipas vizitës edhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore, kërkesat për kandidatin publikohen në webpage dhe për rastin e AU edhe në kanalin e saj televiziv UFO. Rekrutimi në mënyrë të vecantë bazohet në Rregullore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ku si shumatore e të gjitha neneve theksohet meritokracia.</p> <p>GVJ bëri vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore, verifikoi dokumentacionin mbi procedurat dhe dosje rastësore të dy anëtarëve të PAE dhe dy PAK.</p> <p>Në dosjen individuale ishte Vendimi i Dekanatit për shpalljen</p>

	<p>fitues, vendimi i departamentit, vendimi i komisionit të konkursit dhe të dhëna e dokumenta personale si kopja e diplomës, certifikata të ndryshme trainimi, dokumentatë tjera personale si cv, etj, kontrata e punës, elementë të vlerësimit të cilësisë nga studentët, departamenti, etj.</p> <p>Në krahasim me vitet e para, ka rritje të peshës së orëve mesimore që mbulohen me PAE, kjo për shkak të rritjes dhe konsolidimit të stafit. Në vitin 2017-2018 PAE mbulon për vitin akademik 75 % të ngarkesës së personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Ndërsa për Msc ‘Menaxhim Bankar’, personeli akademik efektiv mbulon 72% të ngarkesës, duke respektuar kriterin ligjor në fuqi për këtë komponent.</p> <p>Për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e shkencore ka një hierarki dokumentash e hallkash.</p> <p>Sipas vizitës në insitucion konstatoam se vlerësimi është gjithëvjeter dhe përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi nga drejtuesit e departamenteve • Vlerësimi nga studentët • Vlerësimi nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë <p>Procedurat janë transparente, i vihen në dispozicion punonjësit, hera herës dhe në mënyrë periodike janë objekt diskutimi, etj.</p> <p>I gjithë informacioni mbi procedurat, kriteret, vendimet e komisionit dhe korespondenca midis hallkave që lidhetme rekrutimin e stafit PAE dhe PAK, me fituesit ose jo, ruhet në formë elektronike dhe hard copy në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Arkivës dhe Protokollit dhe kurdoherë është i disponueshëm.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të</p>	<p>Programi Msc në Menaxhim Bankar, mbulohet nga një staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme me tituj e grada shkencore.</p> <p>Në këtë program angazhohen aktualisht 1 Prof. Dr; 2 Prof. As dhe 5 Dr si staf PAE dhe 1 Prof. Dr. dhe 3 Prof. As, si staf PAK”.</p> <p>I gjithë stafi i angazhuar ka përvojë pedagogjike të gjatë në AU ose universitete të tjera.</p> <p>Rektori, Zv/Rektori, Dekani, dhe Përgjegjësi i Departamentit janë të punësuar me kohë të plotë në AU.</p> <p>Thuajse cdo vit ka patur përmirësime të pjesëshme dhe brënda kufirit ligjor të kurrikulave.</p> <p>GVJ konstaton se kurrikula e Msc. në Menaxhim Bankar, per periudhen per te cilen akreditohet ky program, nuk ka praktike profesionale te perfshire. Kurrikula e re qe do te implementohet</p>
---	---

<p>mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>ne vitin akademik 2018-2019, ne kuadrin e ndryshimeve te bera, ka ne perberje edhe lenden e praktkes profesionale</p> <p>Në zbatim të kërkesave të VKM 41 date 24.01.2018 janë përfshirë në kurrikula edhe praktika profesionale, element i munguar më parë. Janë bërë edhe aktet dhe përgatitja për mbarëvajtjen e këtij komponenti si marëveshjet me institucionet, planizimi i numrit të studentëve për cdo pedagog dhe udhëzime konkrete për studentin që do ndjekë praktikën profesionale. Për cdo pedagog janë parashikuar 10 studentë për ndjekje në praktikë.</p> <p>Në këtë proces, sidomos për lidhjen me institucionet që do presin studentët për praktikë profesionale është angazhuar Zyra e Karrierës dhe Alumnit.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Sipas planit mësimor në fuqi, në përfundim të procesit mësimor është parashikuar përgatitja e diplomës dhe mbrojtja e saj. Për këtë në planin mësimor janë caktuar 38 kredite, mbi 25 përqind e krediteve totale, një përqindje kjo mjaft e lartë.</p> <p>Përzgjedhja e diplomave bëhet nga studentët mbështetur në një listë orientuese ose në preferencat e tyre, mbështetur në mundësitë për akses në informacion apo edhe preferencat personale.</p> <p>Për udhëheqjen e diplomave departamenti angazhon stafin e programit dhe jashtë tij, me grada e tituj shkencore dhe me fusha të përafërta me atë të punimit të diplomës.</p> <p>Për cdo pedagog që plotëson kriteret për mbrojtje diplomash respektohet ngarkesa 5 studentë për pedagog.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Eshtë synuar që në shpërndarjen e temave të respektohet fusha e ekspertizës e udhëheqësit.</p> <p>Në arsyetimin tonë, mbështetur edhe në cv e tyre, pedagogët e ngarkuar kanë aftësi të drejtojnë suksesshëm dhe me cilësi temat e përgatitura. Nisur nga lista e diplomave të orientuara por edhe të mbrojtura, në këtë proces, kërkohet të rritet shfrytëzimi i literaturës së huaj dhe strukturimi dhe modelimi i punimit me analiza sasiore e cilësore, mbështetur në metodat e kërkimit bashkëkohore, ekonometri, menaxhimit të riskut, etj dhe të orientohet më shumë kryesisht në fusha konkrete të menaxhimit bankar dhe financiar, ku është edhe fokusi i programit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor</p>	<p>Për natyrën e tij ky program mësimor nuk përmban orë</p>

<p>për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>laboratorike në plan mësimor.</p> <p>Sic u relatua në rubrikat paraardhëse, është synuar një raport i arsyeshëm midis pedagogëve, stafit ndihmë dhe mbështetës dhe numrit të studentëve. Për natyrën e institucionit një pjesë e stafit ndihmës dhe administrativ janë në shkallë institucioni, një pjesë në shkallë fakulteti dhe pak në shkallë departamenti.</p> <p>Programi Msc Menaxhim Bankar, ka asistente dhe sekretare që ndjekin punët me karakter administrativ dhe janë në mënyrë frekvente në shërbim të nevojave të studentëve të këtij programi. Këtojanë të rregulluara në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, nenet 15 dhe 16.</p> <p>Në dispozicion të procesit mësimor dhe nevojave të përditëshme të studentëve janë edhe Personeli i Zyrës së IT-së për mirëmbajtjen e pajisjeve ndihmëse në auditorë, Zyra e Marrëdhënive me Jashtë, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, që ndihmojnë në përmbushjen e objektivave të programit parashikuar kjo në Statutin e Albanian University, neni 11.</p> <p>AU dëshmon se ka një përdorim optimal të burimeve njerëzore, e cila u demonstrua nga stafi administrativ dhe ndihmes mesimor-shkencor edhe gjate vizitave ne institucion</p>
---	---

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli ka ngarkesë mësimore dhe në elementë të tjerë jashtë auditorit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe ekspertizës individuale të stafit, si udhëzimi nr.20, dt.09.05.2008 dhe udhëzimi nr.40, dt.08.12.2009 ku 1 orë leksioni vlerësohet me 2 orë mësimore.</p> <p>Referuar ngarkesës së 2017-2018, te siguruar gjate vizites ne institucion, sugjerohet, që në shpërndarjen e ngarkesës, të respektohet fusha e ekspertizës dhe e kualifikimit të stafit akademik, pasi konstatohen raste te pedagogeve qe mbulojne lende te fushes se finances dhe të manaxhimit; lende te fushes se manaxhimit dhe te Marketingut; (Investime dhe Manaxhim te burimeve njerëzore, apo Manaxhim Burimesh njerëzore dhe Taksim) [<i>Evidence 14,14.Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion</i>]</p> <p><i>Lipset në vijim riorganizimi i ngarkesës sipas udhëzimeve të fundit në këtë drejtim</i></p>
--	---

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mesimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ pati objekt edhe procesin e rekrutimit dhe evidentimin e të dhënave për cdo pedagog të punësuar PAE dhe PAK, nga ku konstatohet se ka një sistem të dhënash ku evidentohen dhe azhurnohen vec të tjerave edhe aftësitë dhe arritjet e herëpashërshme profesionale. në arkivin e Departamentit, si dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Në to ruhen të dhëna individuale, ngarkesa mësimore sipas simestrave</p>
--	---

<p>akademik.</p>	<p>dhe viteve, arritjet shkencore dhe profesionale ndër vite.</p> <p>Sic u relatua edhe më parë, procesi i rekrutimit nis nga përcaktimi i nevojave për staf nga departamenti dhe hartimin e kriterëve për kandidatët e mundshëm deri në përzgjedhjen përfundimtare dhe marëdhënien kontraktore të punësimit me kohë të plotë dhe të pjesëshme. I gjithë ky proces është i evidentuar në vendet vakante, kriteret e pranimit e të dhëna të tjera të nevojshme për publikun publikohen në online në http://albanianuniversity.edu.al/), si dhe në mjetet e tjera të informimit publik si televizioni UFO. Kjo uverifikua gjaatë vizitës në institucion.</p>
------------------	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit, në strategjitë e zhvillimit dhe rregulloret e të gjitha instancave të insitucionit sipas shkallës së ekspertizës dhe lidhjes e kontributit të tij me hallkën përkatëse.

Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore dhe elementët e tjerë të saj sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Në rekrutimin e stafit ka një procedure të hapur e transparente që iniciohet nga departamenti dhe përmyllet me nënshkrimin e kontratës së punësimit për personat fitues. I gjithë dokumentacioni dhe procedurat administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

E njëjta gjë duhet theksuar edhe për vlerësimin e personelit, për secilin anëtar të PAE dhe PAK ka dosje dhe evidentim të të dhënave personale, të arritjeve profesionale dhe shkencore dhe ngarkesave mësimore për cdo semester.

Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore mbajnë të dhëna për anëtarët e personelit të angazhuar në mësimdhënie, arritjet akademike të tyre, kontratën e punësimit, detyrat dhe ngarkesën mësimore, dokumentacionin personal (diplomat e studimeve, listat e notave, certifikata, trajnime, CV, dokumente identifikimi, etj.).

Në funksion të procesit mësimor AU, fakulteti, departamenti dhe vetë programi në shqyrtim ngarkon stafin ndihmës dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme që nga viti në vit k ardhur në konsolidim e sipër. Institucioni ka burime njerëzore të mjaftueshme për të ofruar një program cilësor dhe kushte optimale të kujdesit ndaj studentit.


GVJ vlerëson se standardet përmbushen kryesisht.

Rekomandime:

- *Kërkohet që të rritet përgjegjësia e pedagogut për t'i administruar dhe diferencuar studentët mbi kriterin e vlerësimit më real të frekuentimit dhe pjesmarrjes në mësim, për të cilat ka edhe pikë vlerësuese.*
- *Sugjerohet, që në shpërndarjen e ngarkesës, të respektohet fusha e ekspertizës dhe e kualifikimit të stafit akademik, pasi konstatohen raste te pedagogete qe mbulojne lende te fushes se finances dhe të manaxhimit;*
- *Kërkohet të futet gradualisht frymë më serioze për materialet që ofrohen si literaturë*

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore




Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Sipas vizitës në institucion dhe relatimit në RVB dhe pasqyrat shoqëruese, morem një pamje të plotë të infrastrukturës së AU, ku zhvillohet edhe programi në analizë. Albanian University perفشin një kampus me katër godina, në qendër të kryeqytetit shqiptar me një sipërfaqe 10718 m².

Departamenti i Shkencave Ekonomike e zhvillon procesin akademik, në godinën qendrore në Bulevardin "Zogu I", me sipërfaqe 3996 m². Ambientet e saj janë rikonstruktuar të adoptuara në klasa dhe laboratorë.

Mësimi zhvillohet në mjedise bashkohore ku sallat ishin të pajisura me mjetet e nevojshme si video projektor ekrane të mëdha, flipcharte dhe tryeza pune komode e të organizuara. Sallat dhe zyrat kanë të instaluar sistem kondicionimi ngrohje-ftohje. AU disponon sallë konferencash me teknologji multimediale, audio dhe video, për realizimin e konferencave të koordinuara me sistemin e qendrës së zërit dhe qendrën e përkthimit simultan; laborator informatike në funksion të Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe përdoret gjerësisht nga Ekonometria, Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit etj.

Sipas RVB, rrjeti i kompjuterik që përdoret nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës është i lidhur dhe ka shërbim interneti pa limit në të katër godinat e Albanian University.

GVJ nga vizita që pati në mjediset e bibliotekës, konstatoi se numri fizik i kartelave të studenteve të programeve të studimit të fushës së ekonomisë paraqitet i vogël, krahasur me numrin e studenteve të regjistruar në këto programe.

Universiteti ka sitin e vet (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/>) dhe lidhjet me universitetet simotra në rajon e më gjerë.

Libraria e Universitetit ndodhet në godinën e rrugës së Durrësit. Në librarinë e AU është edhe shërbimi i fotokopjes për nga studentët dhe pedagogët.

AU boton revistën shkencore OPTIME boton punim e kërkime dhe punime shkencore të ndryshme dhe ato të vetë stafit.

AU zotëron Albanian University Press, ndërmarrje botuese, që boton tekste mësimore dhe shkencore në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve. Kjo ndërmarrje botuese regjistron në listën e saj një volum të konsiderueshëm botimesh, si libra, tekste mësimore, tituj të rëndësishëm studimorë, akademikë dhe shkencorë.

Albanian University disponon kanalin televiziv kombëtar UTV, për zgjerimin e spektrit të tyre të dijeve të përvetësimit të informacioneve të reja mbi shkencën, të mënyrës së të arsyetuarit dhe diskutimit të shumë problemeve në fushat respektive që ata studiojnë. Studentët herë herës marrin pjesë në formatet e ndryshme televizive.

Ka në funksion lokal në vetëshërbimit ushqimor për të gjithë studentët e AU. Ambientet kanë shërbim sigurie, sistem kamerash vëzhguese në të gjitha hollët e kateve dhe në mjediset e jashtme.

AU disponon edhe zyrën e informacionit dhe receptionit që mundëson shërbim për çdo informacion që kërkohet si nga ana e studentëve e të tjerë të interesuar.

Thëksojmë se e gjithë infrastruktura e përshkruar më sipër aksesohet lehtë nga studentët e programit Msc në Menaxhim Bankar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

AU dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programit të studimit, të përbërë nga 10 salla leksionesh, 20 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjësinë e njësisë bazë etj. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ato janë të pajisura me videoprojektorë, dhe

komputera. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për programin e studimeve.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas RVB institucioni disponon salla leksionesh, seminare, laboratore, biblioteka, etj. me sipërfaqe totale 4618.2 m² për 652 studentë, pra 7.08 m²/student (Tabela 6 në aneks).

Edhe ambientet e stafit janë përgjithsisht brenda kushteve dhe normave. Ka zyra te vecanta për dekanin, sekretarinë mësimore, departamentin, financën, NJBSC, të Koordinimit e Mbështetjes së Studentëve, etj, me sipërfaqe totale 231.47 m² për 69 persona pra 3.4 m² për person (shih tabelat në anekset e raportit)



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Infrastruktura e AU, është e vendosur kryesisht në qendër të Tiranës, me 4 godina sipas fakulteteve. Departamenti i Shkencave Ekonomike e zhvillon procesin e tij mësimor në mjediset e selisë qendrore të AU, me një sipërfaqe totale prej 3996 m².</p> <p>Ambjentet disponohen me kontrata nga AU, që nga viti 2006.</p> <p>Programi i studimit MSc në Menaxhim Bankar zhvillohet vene godinën qendrore.</p> <p>Institucioni ka garantuar kapacitete të mjaftueshme laboratorike dhe të pajisura për realizimin e programeve të studimit</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion u pa edhe biblioteka me të gjithë aksesoret e saj.</p> <p>Disponohet literaturë e huaj dhe vendore si dhe literaturë online. Përgjithsisht tekstet në shqip janë ato të universiteteve publike dhe një pjesë e këtyre teksteve bazë janë edhe me autorësi të pedagogëve të AU.</p> <p>Në literaturën plotësuese rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj.</p> <p>Në bibliotekën e godinës qendrore janë rreth 1200 tituj të disponueshëm nga të cilët 331 tituj janë në ndihmë të programeve të shkencave ekonomike, 83.000 libra akademike, 10 milionë artikuj shkencorë disponon edhe libraria elektronike "QUESTIA". Në bibliotekë disponohen edhe botime periodike të Albanian University Press, revista e universitetit "Optime" kanë botime periodike me libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, përgatitjen e tezës.</p> <p>Shtimi i fondit të bibliotekës realizohet cdo vit mbi kërkesat e departamenteve GVJ disponoi kërkesën e departamentit për bibliotekën në vitin e fundit.</p>

	<p>Biblioteka zbaton një orar disponibel dhe oportun për studentët. Në periudha provimesh ka edhe orare shërbimi shtojce.</p> <p>Për çdo student ka kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës.</p> <p>GVJ sugjeron që literatura të përditësohet me botimet e fundit të fushave respektive, referuar këtu programeve të lëndëve dhe literatures se parashikuar ne to.</p> <p>GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që programi Master i shkencave në Menaxhim Bankar, dhe përkthime të bëra nga universitete të tjera(UET, etj) te teksteve fundamentale në këtë fushë.</p> <p><i>U kontaktua një frekuentim jo i kenaqshëm bibliotekës nga ana e studentëve bazuar në rregjistrimet në kartelat dhe librat e tërhequr, mungesë e disa botimeve bazë në shqip në disiplinat bazë të programit, dhe të disa përkthimeve të teksteve të bëra nga universitete të tjera, sic është rasti nga UET.</i></p> <p>Shkak mund të jetë disponibiliteti në gjuhë të huaj, kërkesa dhe orientimi i limituar nga pedagogët për tema kursi detyra kursi, tema diplome, etj,</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme për mësimdhënie, përmban klasa me hapësira të mëdha dhe të bollshme, salla konferencash të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për të zhvilluar një edukim cilësor, të cilat janë të pajisura me kompjuter, video-projektor, ekrane të mëdha, flipcharte, multimedia.</p> <p>Ambientet janë komode, klasat kanë tryeza pune që në raste leksionesh të hapura, diskutimesh shkencore apo aktivitete të tjera informuese e bashkëbiseduese vendosen në formën e një rrethi për të nxitur ndër-veprimin dhe mundësuar zhvillimin e bashkëbisedimit më lehtësisht në auditor midis grupeve të mëdha dhe të vogla.</p> <p>Të gjitha klasat mësimore janë të pajisura me mjetet audio vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor efektiv, ku përfshihen kompjuterët personal (PC), video projektorë, sistem fonie, sistem kondicionimi, internet wireless, etj.</p> <p>Për të përmbushur nevojat e programeve në mesin që realizohet programi është ngritur laborator i informatikës, me kapacitet prej 30 personash, që përdoret për lëndët “Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit”, “Ekonometri” dhe për tema të veçanta në lëndë të tjera, për të bërë të mundur një mësimdhënie sa me efektive dhe për t’u ardhur</p>
--	---

në ndihmë studentëve. Ky laborator nëpërmjet programeve të instaluar "Microsoft Office", "Programi Bilanci" dhe "UMS" ndihmon studentët për punët dhe detyrat që kanë në programin e secilës lëndë apo edhe në temat e diplomave. Laboratori ka mundësi që t'ju shërbejë disa programeve të studimit, sipas një skedulimi normal të orarit të punës.

Një punonjës i IT është gjithnjë në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorëve dhe rrjetit kompjuterik të AU gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore. Pedagogët dhe studentët janë të asistuar vazhdimisht prej tij në shërbim të asistencës teknike në laboratorin e informatikës.

Institucioni disponon laboratorë të kompletuar për të gjitha programet e studimit.

GVJ referuar tabelave 6 dhe 7, sugjeron shtim të ambienteve për stafin akademik të departamentit, duke qënë se ky department ka ardhur duke u zgjeruar në vite dhe aktualisht ka 23 pedagoge efektive pa përmendur edhe të jashtmit

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstaton se infrastruktura e AU dhe e programit në diskutim, është e përshtatëshme, funksionale dhe përballon plotësisht kërkesat e programit Msc Menaxhim Bankar.

Ajo është e organizuar mbi bazë institucioni dhe përbëhet nga klasa me hapësira të mëdha, me mjetet teknologjike dhe tryeza pune komode, salla konferencash të pajisura me kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, etj.

Institucioni ka bibliotekën e tij të pajisur me mjetet dhe librat e domosdoshme që krijojnë mundësinë e zhvillimit të procesit mësimor. Biblioteka ka një fond të pasur me botime hardcopy dhe elektronike si në gjuhën shqip ashtu dhe në gjuhë të huaj përmes librarisë online.

U kontaktua një frekuentim jo i kënaqshëm i bibliotekës nga ana e studentëve bazuar në regjistrimet në kartelat dhe librat e tërhequr, mungesë e disa botimeve bazë në shqip në disiplinat bazë të programit.

Institucioni ka laborator informatike që lipset të përdoret më shume atje ku është e nevojshme edhe nga disiplina të vecanta të programit.

GVJ vlereson se standardet përmbushen kryesisht

Rekomandime:

- *GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore të viteve të fundit, përkthime të bëra nga universitete të tjera të teksteve fundamentale në këtë fushë, me botime akademike periodike, periodikë ndërkombëtarë, plotësim të programit me libra bazë, ndihmës dhe të ushtrimeve, në përputhje me lëndët e programit Master i shkencave në Menaxhim Bankar.*
- *GVJ sugjeron shtim të ambienteve për stafin akademik të departamentit, duke qënë se ky department ka ardhur duke u zgjeruar në vite dhe aktualisht ka 23 pedagoge efektive pa përmendur edhe pedagogët me kontratë.*

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Të ardhurat kryesore të AU dhe të programit Msc Menaxhim Bankar, janë tarifatat e studentëve, por edhe nga aktivitetet e tjera tregtare. Të gjitha të ardhurat nga tarifatat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese.

AU ka njësi të vecantë për menaxhimin e burimeve financiare. Kjo është saksionuar në statutin e institucionit.

Raporti financiar certifikohet cdo vit, ai përmban burimet e të ardhurave dhe drejtimet e shpenzimeve.

Burim kryesor i të ardhurave janë tarifatat e studentëve dhe zëri kryesor i shpenzimeve janë pagat e punonjësve.

Institucioni ka mbuluar me të ardhurat shpenzimet e tij. Eshte realizuar heqja e tarifës së regjistrimit për të gjithë studentët dhe nuk zbatohet.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

GVJ vlereson si praktike, heqjen e tarifës së regjistrimit për të gjithë studentët dhe mos aplikimi i tarifave të tjera shtesë për provimet në sesionin e parë. Studentët paguajnë vetëm tarifën e programit të studimit, nuk ka pagesë ekstra për aplikimin fillestar dhe regjistrimin përveç tarifës së studimeve.

GVJ vlereson praktiken e ndjekur nga institucioni që përveç certifikimit të pasqyrave financiare nga audituesi i pavarur, AU ka në strukturën e vete edhe zyra e auditit të brendshëm që realizon kontrollin dhe auditimin e brendshëm që funksionon pranë Zyrës të Financës dhe varet nga Bordi i Administrimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Sipas RVB dhe pasqyrave që e shoqërojnë atë, të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) paraqiten:

- Grantet për kërkim	0%
- Konsulentat, shërbimet	0%
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit	99.6%
- Sponsorizimet	0%
- Shërbimet trainuese	0%
- Donacionet, aktivitetet, fondacione	0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, etj)	0.4%

Sipas RVB shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honorarët në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit.

Kostoja për një student, në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Bankar është 125000 lekë/vit akademik.

Lipset që për cdo program të hartohet dhe jetë transparente të ardhurat dhe shpenzimet gjithsejt. Në këtë të fundit duhet qartësuar pjesa e shpenzimeve fikse dhe administrative të departamentit, të fakultetit dhe institucionit, që duhet ti ngarkohet përafërsisht programit dhe mbi këtë bazë të llogaritet saktë dhe drejtë eficientia e programit, rentabiliteti i tij dhe të jetë një bazë e arsyeshme për mirëmenaxhimin dhe krahasimin e efektivitetit të programeve.

Pranë zyrës së Financës atashohet edhe auditimi i brendshëm që varet nga Bordi i Administrimit dhe ben auditime të përvitëshme.

Organi më i lartë administrativ është Bordi Administrimit, që garanton mbarëvajtjen dhe administrimin financiar. Ai ka 7 anëtarë, 3 të emëruar nga Senati, dhe 4 të tjerë nga shoqëria tregtare. Këto detaje janë saksionuar edhe në rregulloren e AU.

Administratori i përgjithshëm është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të AU. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitëshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficientën e përdorimit të të ardhurave nga tarifët e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Cdo vit bëhet auditimi i AU duke certifikuar bilancin e tij nga kontabilist i miratuar sipas standardeve përkatëse.</p> <p>AU nuk ka përfituar grante të huaja nga kontratat e shërbimeve.</p> <p>Raportet e auditit synojnë të bëjnë analizën e eficientës së të ardhurave, por që të jetë kjo e plotë e saktë dhe bindëse duhet llogaritur kostoja e plotë direkte dhe indirekte për cdo program, gje që mundon në analizat financiare të institucionit.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Në mënyrë të përvitëshme AU harton raport financiar, me të dhëna mbi të ardhurat, shpenzimet dhe komponentë të tjerë financiarë. Në të paraqiten burimi i të ardhurave ku dominojnë tarifët e shkollimit dhe llojshmëria shpenzimeve operative ku dominojnë pagat e punonjësve dhe elementë të tjerë, Raporti certifikohet cdo vit. Me qëllim ndjekjen e saktë dhe menaxhimin më të mirë të eficientës, rentabilitetit për cdo program duhet të hartohet pasqyrë të ardhurash dhe shpenzimesh për cdo program ku të zgjidhet metodikisht kuota e shpenzimeve fikse të departamentit, fakultetit dhe institucionit që duhet të alokohet programit dhe mbi këtë bazë del rezultati financiar për cdo program.</p> <p>Raporti ka të dhëna për të ardhurat nga tarifët e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Raporti disponohet nga Zyra e Financës.</p> <p>Rezulton se AU ka qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacitete financiare për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p>GVJ konstaton prej informacionit të paraqitur në RVB, se ka ardhur në rënie numri i studentëve që ndjekin këtë program. Prandaj GVJ sugjeron diversifikimin e burimeve financiare,</p>

jo vetëm nga tarifat e studimit si deri tani dhe që kanë ardhur duke u zvogëluar, por edhe nga burime të tjera të tjera si grantet, konsulentat, projektet, të cilat përvçse krijojnë mundësi të tjera financimi, i shërbejnë institucionit edhe në kuadrin e kërkimit shkencor dhe rritjes së kontributit institucional në komunitetin shkencor

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ gjykon se AU dhe programi në analizë paraqiten me qëndrueshmëri financiare. Rëndësi në këtë drejtim ka ruajtja e numrit të studentëve të rregjistruar që vitete fundit paraqet probleme. Raportet financiare certifikohen çdo vit. Ka rritje të të ardhurave dhe kjo e ardhur nga rritja e numrit të studentëve dhe jo e tarifave si institucion.

Grupi i vlerësimit ka konstatuar një organizim dhe mbajtje të rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Respektohen rregullat lidhur me auditimin e situatës financiare të shoqërisë dhe theksohet se të ardhurat e vetme janë tarifat e studentëve. Dokumentacioni i lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe dëshkohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike, të cilave u është nënshtruar Institucioni.

Fondet përdoren me përgjegjshmëri gjë që krijon kushtet për vazhdimësinë e procesit mësimor.

Vihet re nivel konstant i të ardhurave (dhe rritje të ndjeshme vitet e fundit. Institucioni ka qëndrueshmëri financiare.

Për të gjykuar drejte mbi eficiencën e fondeve për çdo program duhet lokalizuar të ardhurat dhe sidomos shpenzimet për çdo program, gjë që deri tani është bere në mënyrë empirike dhe pa marrë në konsideratë shpenzimet fikse të departamentit, të fakultetit dhe institucionit që i perkasin një programi të caktuar.

GVJ shprehet se standardet përmbushen kryesisht

Rekomandime:

- *GVJ sugjeron diversifikimin e burimeve financiare, jo vetëm nga tarifat e studimit si deri tani dhe që kanë ardhur duke u zvogëluar, por edhe nga burime të tjera të tjera si grantet, konsulentat, projektet, të cilat përvçse krijojnë mundësi të tjera financimi, i shërbejnë institucionit edhe në kuadrin e kërkimit shkencor dhe rritjes së kontributit institucional në komunitetin shkencor*

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sigurimi i cilësisë është komponent kyç në mbarëvajtjen e institucionit dhe programit Msc Menaxhim Bankar. Ky sistem në shkallë institucioni vepron nga viti 2009 -2010.

Sic u verifikuar nga GVJ në vizitën në institucion, me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, AU ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe së fundmi, në përputhje me ligjin 80/15, me Vendim Nr. 4, të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë. Kjo është sanksionuar në statutin e AU, nenet 65, 66, 67.

NjsBC në bazë të politikave dhe kriterëve të përshtatshme, orienton dhe monitoron sigurimin e brendshëm të cilësisë. NjBSC varet nga Rektori i Universitetit, përgatit raportin vjetor dhe ka për detyrë paraqitjen e një

raporti vjetor me vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar dhe rekomandon masa për përmirësimin cilësisë. Ky raport i paraqitet senatit akademik dhe publikohet në faqen zyrtare web.

FukSIONET dhe detyrat e NJSBC, parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Universitetit dhe në Rregulloret specifike për SB të Cilësisë. NJSBC mbështet, këshillon, bashkërendon, monitoron dhe administron e dhe ofron ekspertizë në proecin e sigurimit të cilësisë. NJSBC dhe Komisioni për Vlerësim Institucional hartojnë politikat e vetëvlerësimit, përcaktojnë kriteret e vlerësimit, realizojnë anketimet e raportimet, etj.

Nga viti 2016, NJSBC funksionon edhe në nivel fakulteti sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 157/3, dt. 08/09/2016

Nga NJSBC e njësisë bazë vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kjo realizohet me të dhëna statistikore sipas anketimeve të studentëve, fokus – grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njësive bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët.

Njësia bazë bashkëpunon me NJSBC dhe kjo e fundit, evidenton problemet, bën rekomandimet për përmirësimet e nevojshme për rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor,

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Sipas Raportit të Sigurimit të Cilësisë konsultuar gjatë vizitës në Institucion, cdo vit realizohen 2 anketime, para sezonit të provimeve. Rreth 50% e studentëve kanë marrë pjesë në anketime. Në programin Msc Menaxhim Bankar janë anketuar 34 % e studentëve, që na duket e pajustificuar të jetë në këtë nivel, nisur edhe nga numri relativisht në rënie studentëve në këtë program.

Sipas analizave të bera anketimeve, vlerësimi i studentëve ka qënë pozitiv dhe ku mungojnë rekomandimet për problematikat e programit, gjithë që mendojmë se nuk përbën sens dhe tregon për një lloj formalizmi në anketime apo edhe pyetësor standard dhe që nuk evidenton problematikat.

Rezultatet kanë ndjekur rrugën e diskutimit në njësinë bazë, njësinë kryesore dhe në rektorat.

Në semestrat pasardhës është synuar përmirësimi i çështjeve problemore të mundshme që kanë rezultuar nga zhvillimi i pyetësorëve, si në raport me stafin akademik ashtu edhe në raport me literaturën dhe përmirësimin e shërbimeve universitare në përgjithësi.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, nga NJSBC dhe nga Komisioni për Vlerësim Institucional (një nga anëtarët e Komisionit është personel akademik efektiv i Departamentit të Shkencave Ekonomike

Njësia bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor, ku përfshihen të dhëna përshtetëse dhe sasiore mbi çështje mbi gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, behet analiza SWOT.


Politikat e përmirësimit të cilësisë janë parashikuar në Planin Strategjik i Zhvillimit të Institucionit '2017-2022'

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Institucioni dhe për rjedhojë edhe programi Msc Menaxhim Bankar vlerëson në fund të cdo semestri ecurinë e programit të studimeve. Njësia bazë dorëzon në fund të
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në	

<p>vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Te tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; <p><u>Te drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>semestrin të parë dorëzon raportin semestral, ku jepen rezultatet e studentëve dhe të anketimeve.</p> <p>Sipas vizitës në institucion konsultuam edhe raportin vjetor të departamentit ku pasqyrohen rezultatet vjetore dhe bëhet një analizë krahasimore</p> <p>Institucioni përfshin të dhënat e raporteve semestrale siç kalueshmëria, notat mesatare realizimin e objektivave në RVB për programin e studimit. Raporti vjetori i AU dhe analiza swot botohen në.</p> <p>http://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2017/04/Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017-Perfundimtar.pdf</p> <p>NJSBC-së ka stabilizuar një set metodash dhe kriteresh të drejtpërdrejta dhe tërthorta për vlerësimin. Si metoda të drejtpërdrejta janë aplikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi me nota dhe pikë; - teste paraprake dhe përfundimtare. <p><i>Në këtë set duhen përfshirë edhe vlerësime nga konkurimet e studentëve të diplomuar dhe sukcesi i tyre, rezultatet nga punët në detyra kursi, pune individuale, vëzhgime gjatë praktikës, rezultate të kërkimit, etj.</i></p> <p>Si metoda të tërthorta janë aplikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anketime dy herë në vit me studentë, - Fokus grupe nga NJBSC në muajin dhjetor, mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj.
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Raporti i NJBSC publikohet në faqen zyrtare të universitetit sikurse edhe në këndet e njoftimeve në universitet.</p> <p>Ky raport që i paraqiten njësisive respektive bëhet objekt diskutimi në nivel departamenti, fakulteti e Rektorati.</p> <p>Objekt pune i NJSBC janë edhe trainimet për vlerësimin e brendshëm me stafin e angazhuar në këtë proces në të gjitha nivelet e institucionit. Materialet e trainimit publikohen edhe ne faqen zyrtare te internetit të Institucionit.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi Mcs Menaxhim Bankar, ecuria e tij, problematikat, etj kanë qënë objekt i analizës vjetore në kuadrin e analizës së programeve të ciklit të dytë ofruar nga fakultet. Objekt në raport janë cilësia e syllabuseve, cilësia e mësimdhënies, rezultatet e arritura, literatura e shfrytëzuar, problemet me komunikimin, seriozitetin,</p>

	<p>etiken dhe korektesen, raportin me studentet, me administraten, me departamentit, me departamentet e tjera.</p> <p>Objekt raporti është kalueshmëria për cdo lëndë dhe problematikat e lindura. Dhe prioritetet për të ardhmen.</p> <p>Në strategjinë dhe rregulloret e institucionit dhe politikat e tij synohet përmirësimi dhe përsosja e programit Msc Menaxhim Bankar , konsolidimi sasior dhe cilësor i tij.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>AU me vendim të Bordit të Akreditimit nr 90 datë 20.10.2017 ka patur akreditimin institucional ka fituar kohëzgjatjen 2 vjecare.</p> <p>Për sigurimin e cilësisë AU ka ngritur strukturat e cilësisë nga njësia bazë deri në institucion, Ato përdorin instrumentat e duhur për monitorimin e cilësisë. Si bazë ka shërbyer Manuali për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”</p> <p>Pavarësisht formalizimit të procesit të vlerësimit nga AU dhe mekanizmave formal që përdor, GVJ mbështur në mungesën e informacionit nga takimet me studentë të programit master, sugjeron intensifikimin e proceseve informuese nga ana e institucionit, me qëllimin ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në programin e studimit qe ata ndjekin, si dhe integrimin me te plote te ketyre studenteve ne proceset e vleresimit</p> <p>AU ndjek procedura të rregullta dhe periodike vlerësimi. nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund semestri.</p> <p>Cdo vit rishikohen programet e studimit, syllbluset ku grupet e cilësisë inkurajojne organizojne, ndjekin dhe formalizojne ne instancat më lart rishikimin e kurikulave ne nivelet e lejuara ligjore brenda institucionit. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat.</p> <p>Studentët dhe stafi akademik familjarizohen në fillim të cdo viti në javë orientuese me fenomenin, procesin dhe objektivat e rritjes së cilësisë, përfitimet e tyre nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.</p> <p>Institucioni ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë sëveprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore që ofron.</p> <p>Sic u verifikua nga GVJ gjatë vizitës në institucion sigurimi i cilësisë është pjesë e Planit Strategjik i Zhvillimit</p>




Konkluzionet e vlerësimit:

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon në AU nga viti 2009-2010 dhe ka një politikë të qartë për sigurimin e cilësisë në të gjithë nivelet e shërbimit të universitetit. Ky Institucion, aktualisht ka ngritur një sistem të përbërë nga struktura të cilësisë në të gjitha hallkat, dhe ato funksionojnë sipas një rregulloreje dhe me objektiva të qarta.

Duke qene se programi i studimit, Msc. ne Menaxhimin Bankar ka numër të kufizuar të studentëve, sugjerohet që NJSBC të përdorë mekanizma që rrisin pjesëmarrjen e studentëve, që të sigurohet një informacion më i plotë dhe objektiv

Mbi baza periodike, NJBSC përgatit raporte dhe raporton në Institucion mbi problematikën dhe ndjek, monitoron e bashkëpunon ne te gjitha hallkat dhe njësitë e nivelitet për sigurimin e cilësisë. I gjithë ky proces ka dhënë efektet etij në përmirësimin e parametrave të cilësisë në gjithë veprimtarinë mësimore e kërkimore-shkencore të Institucionit, duke u bazuar në Standardet Shtetërore të Cilësisë.

NJBSC ka aplikuar metodika të drejtpërdrejta dhe tërthorta për te evidentuar e identifikuar problemet me cilësinë dhe i ka zbatuar ato në mënyrë periodike. Ato lipset të jenë objekt i rishikimit dhe përsosjes së herëpashershme, tashmë që baza është e ngritur dhe eksperiencia është fituar.

GVJ vlerëson se standardet përmbushen**Sugjerime:**

- Duke qene se programi i studimit, Msc. në Menaxhimin Bankar ka numër të kufizuar të studentëve, sugjerohet që NJSBC të përdorë mekanizma që rrisin pjesëmarrjen e studentëve, që të sigurohet një informacion më i plotë dhe objektiv.
- GVJ mbeshetur në mungesën e informacionit nga takimet me studentë të programit master, sugjeron intensifikimin e proceseve informuese nga ana e institucionit, me qëllimin ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në programin e studimit që ata ndjekin, si dhe integrimin më të plotë të këtyre studentëve në proceset e vlerësimit.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**7. Programi i studimit, organizimi i tij****Pjesa përshkrimore**

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Sipas strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe të vetë programit Msc 'Menaxhim Bankar', misioni i programit është përgatitja e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat dhe specifikisht në sektorin financiar (Banka Qendrore e Banka të nivelit të dytë), në sektorin publik dhe organizata jo-fitimprurëse, duke siguruar një arsimit të gjerë profesional dhe shkencor. Programi është strukturuar për të edukuar studentët me njohuritë bazë në fushat e menaxhimit të financave të një entiteti apo financave publike, administrimit te financave lokalene përshtatje me nevojat e tregut të punës.

Ky program synon të nxisë dhe të zhvillojë të menduarit kritik dhe thellimin e njohurive të studentëve, nëpërmjet metodologjive të ndryshme të mësimdhënies, zgjidhjes së problemeve krahas njohjes së studentëve me zhvillimet më të fundit në fushën e menaxhimit, strategjisë, marketingut, financës, etj.

Sipas RVB dhe gjithë legjislacionit dhe bazës rregullative të tij në institucion, fakultet, dhe departament, programi i studimit, synon njohuri të thelluara në fushën e biznesit kombëtar dhe ndërkombëtar, në fushën e administrimit të biznesit, në funksion të të cilave janë ndërtimi curriculave, i gjith procesi mësimor, praktika profesionale, përgatitja e diplomës, etj..

Sipas RVB, ndërtimi planit mësimor dhe curriculave për Msc Menaxhim Bankar është hartuar në përputhje me kërkesat e Kartës së Bolonjës, dhe konsultuar me kurrikula të shkollave të larta homologe Evropiane dhe Amerikane, si të Universitetit “Depaul” Çikago, të Universitetit “Aleksandër” Selanik, të shkollës së Lartë Ekonomike Varshavë, të Universitetit Ndërkombëtar të Prishtinës, “Deere College” në Athinë dhe të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës.

GVJ, duke bërë një analizë të ndryshimeve të ndodhura në planet mësimore, krahasuar me ato që kanë qënë, arrin në përfundimin se planet mësimore aktuale kanë për qëllim aftësimin e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e Menaxhimit. GVJ konkludon se ndryshimet e ndodhura kanë përmirësuar kurrikulën e studimeve për këtë program studimi

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Master i Shkencave në ‘Menaxhim Bankar’ është licencuar me VKM nr. 56, datë 21.01.2009 “Hapja e Programeve të reja të studimit, të Ciklit të Dytë, Pranë Shkollës së Lartë Universitare Private “UFO Dental”. Është akredituar për herë të parë me VKA nr. 355, datë 13.07.2012, me Urdhër nr. 327, datë 07.08.2012. Aktualisht programi është në stadin e akreditimit periodik.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi është organizuar në dy vite akademike, katër semestrat. Cdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor, 1 orë mësimore ka 50 minuta dhe 1 kredit vlerësohet me 25 orë. Me përmbylljen e detyrimeve, studentit fiton diplomë *Master i Shkencave në Menaxhimin Bankar*.

Programi është i ciklit të dytë, me 2 vite akademike, me 120 ECTS. Në respekt të kërkesave të udhëzimeve në fuqi, disiplinat e programit janë organizuar në:

- A. lëndë të formimit bazë (12 ECTS)
- B. lëndë të formimit karakterizues (46 ECTS)
- C. lëndë të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese (12 ECTS),
- D. lëndë me zgjedhje (12 ECTS)
- F. Tema e diplomës (38 ECTS)

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor për programin “Master i Shkencave” në “Menaxhim Bankar”, jepet ne Anekse, Tabela 10 dhe Tabela 11, sipas viteteve akademike, semestrave, fondit të orëve në auditor dhe jashtë tij, numrit të krediteve, formës së shlyerjes së detyrimit.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Në përcaktimin e numrit të krediteve, njësia bazë dhe ajo kryesore kanë respektuar Udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008, “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, sipas të cilit një kredit për leksionet vlerësohet me 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë punë e pavarur; për seminarët 6-8orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur, provimi përfundimtar 3 orë në auditor dhe 22 orë punë e pavarur.

Programi nuk ka laboratore dhe deri në momentin e vizitës së tanishme për riakreditim nuk ka edhe praktikë profesionale.

Gjykojmë se fondi 38 kredite për punimin e diplomës dhe orët e parashikuara për përgatitjen e saj 120 orë në auditor dhe 850 orë jashtë tij janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të realizohen konkretisht në kushtet e Institucionit.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 12 ne Aneks)

IAL ka patur në vëmendje të vazhdueshme rishikimin e planit mësimor. Me vendim të Këshillit të Fakultetit nr. 1, datë 07.09.2015 në bazë të sugjerimeve të një grupi pune me ekspertë të fushës janë bërë ndryshime në syllabuset e lëndëve "Mbikëqyrje Bankare dhe Financiare", "Analizë Financiare e Avancuar", "Kontabilitet i Avancuar", "Qeverisje e Korporatave", "Ekonomiks i Zonës Monetare Europiane". Masa e ndryshimeve nga GVJ vlerësohet brënda brenda normave të lejuara nga MASR.

Në momentin e vizitës në institucion GVJ konstatoi se Departamenti po punon për përshtatjen e planit me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ku ndryshimi më thelbësor është grupi i disiplinave mësimore nga gjashtë në pesë. MASR ka miratuar ndryshimet në kurrikulën e këtij programi studimi dhe për vitin akademik 2018-2019 do të implementohet plani mësimor sipas akteve ligjore në fuqi. Më konkretisht plani mësimor dipas disiplinave karakterizuese me këto ndryshime të reflektuara paraqitet në tabelën 11 në anekset e këtij raporti

Meqënëse kjo vizitë përkon me momentin e këtyre ndryshimeve i rekomandojmë institucionit dhe njësisë bazë të reflektojë edhe ndryshime të tjera sidomos në planin mësimor qoftë edhe duke zbatuar pjesërisht lëndë me zgjedhje, duke forcuar boshtin e lëndëve bankare e financiare dhe kryesisht në planin kombëtar, e duke vënë disa nga lëndët aktuale me zgjedhje. Disiplina të tilla si Menaxhimi bankar, kontabiliteti bankar, raportimi financiar në fushën bankare, menaxhimi i riskut, auditim bankar dhe e drejta financiare dhe bankare, gjykojmë se do të përputhin drejtë emërtimin dhe fokusin e programit me përmbajtjen e tij, dhe do të ngushtojnë disi orientimin e produktit të këtij programi drejt sistemit financiar dhe bankar. Kjo mund të realizohet pjesërisht edhe në disa disiplina ekzistuese pas ndryshimeve të fundit, duke u reflektuar në syllabuse orientimi i tyre në fokusin bankar. Është fjala për kontabilitetin e avancuar, e drejta bankare, menaxhimi e riskut, etj. Për fushat e tjera të pretenduara e relatuar në strategji, Institucioni, pas një studimi tregu, mund të shohë mundësinë e masterit shkencor në financë kontabilitet, Master i Shkencave në administrimin publik apo fusha e emërtime të përafërta

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 13 në Aneks)

Plani mësimor i lidhur me stafin akademik që mbulon çdo lëndë për vitin 2017-2018, jepet në tabelën 13, në shtojcën bashkëlidhur.

Gjatë vizitës në institucion u verifikuar ndarja e lëndëve sipas pedagogëve sipas kualifikimit dhe ekspertizës së tyre nga ku rezultoi se ka një përputhje të pranueshme dhe që garanton cilësinë e ofrimit të disiplinave të përfshira në planin mësimor. I gjithë stafi i angazhuar në program mban tituj e grada shkencore. Nga 14 disiplina në programin Msc Menaxhim Bankar, 10 prej tyre ofrohen nga PAE dhe 4 nga staf PAK. Në mënyrë të hollësishme ky organizim paraqitet në tabelën 13 pjesë e këtij raporti vlerësimi në anekset shoqëruese.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga GVJ u shqyrtuan te gjitha syllabuset e lëndëve pjesë e dosjes së aplikimit, nga ku rezulton se në përgjithsi janë respektuar rubrikat e ndërtimit të syllabusit, objektivat e lëndës, detyrimet e studentit, plani i orëve dhe javët sipas planit mësimor, metodat e vlerësimit, komponentët dhe temat e lëndës, semestri kur zhvillohet lenda, literarura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse, etj. Ato ishin të nënshkruara nga pedagogu i lëndës dhe drejtuesi i njësisë bazë, përgjegjësi i departamentit. Në pothuaj të gjitha syllabuset si literaturë bazë është ndonjë tekst bazë i universiteteve publike, apo edhe botime apo shënime të pedagogut.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Gjykojmë se departamenti dhe cdo pedagog duhet të synojnë të evitojnë shënimet apo edhe thjesht prezantimet në .ppt e lëndës dhe të rekomandohet material i plotë bazë në shqip, pasi edhe ekzistojnë të tilla. Ndërkohë meqënëse është master i Shkencave ku dhe gjuha e huaj është kriter hyrës, për vlera të programit, akreditim të tij edhe në nivel ndërkombëtar, etj gjykojmë se literaturë bazë mund të jetë tekst i huaj, dhe materialet në shqip si literaturë e dytë bazë ose edhe literaturë ndihmëse. Kjo për disa nga lëndët si 'Financa Korporatash', 'Menaxhim Fiskal', 'Menaxhim sigurimesh', 'Menaxhim Strategjik', 'Auditim i Institucioneve Financiare', 'Metodat Sasiore në Financë', 'Qeverisja e Korporatave', 'Menaxhim Portofoli'.

Meqënëse është master në fushën e bankave por edhe të sistemit financiar, rekomandojmë të orientohen më shumë çështje që lidhen me këta sektorë, në lëndët:

- 'Mbikqyrja bankare dhe e sigurimeve' duhet të jenë të pranishme elementë mbikqyrës që aplikojnë AMF dhe Banka e Shqipërisë, departamentet përkatëse,
- 'Menaxhim fiskal' ku duke vlerësuar nivelin makroekonomik të temave të rekomanduara mund dhe duhet të jenë të pranishme edhe tema që lidhen drejtpërdret në aspektin fiskal edhe me fushat ku ofrohet programi,
- 'Sistemi financiar dhe bankar', 'Auditim i insitucioneve financiare', ku realisht materiali i drejtohet standarteve të auditimit kryesisht në bizneset private, dhe thuajse mungon auditimi bankar,
- 'Kontabilitetin financiar' që zhvillohet me literaturën bazë kontabiliteti financiar, dhe thuajse mungojnë elementë të kontabilitetit bankar,
- 'Edrejta financiare' që i adresohet sistemit financiar ne aspektin e së drejtës dhe mungon tërësisht elementë të së drejtës bankare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi Msc në Menaxhim Bankar i ofruar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike është i akredituar. Gjatë vizitës në institucion GVJ u konsultua me një tabelë përmbledhëse e programeve dhe akreditimeve. Për herë të parë programi i studimit MSc në Menaxhim Bankar është akredituar Urdhër nr.327, datë 07.08.2012, me vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 355, datë 13.07.2012. Këtë vit i nënshtrohet akreditimit periodik. Programi dhe syllabuset janë ndërtuar me sistem kreditesh të shpërndara në dy vite me nga 60 kredite dhe katër semestra.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të	Programet e ciklit të dytë janë ndërtuar në mbështetje të strategjisë së zhvillimit të institucioni dhe me objektivat strategjike. vizionin e tij. Si diplomë hyrëse në këtë program kryesisht shërben ajo bachelor në Financë-Bankë; Programi synon të përgatisë menaxherë dhe specialistë për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit; ai synon të kombinojë njohuritë akademike me botën reale, mësimin me kërkimin, shkallë elasticiteti në hartimin e programit dhe syllabuseve, për t'ju përshtatur tregut..

<p>ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MSc në Menaxhim Bankar është ndërtuar duke patur bazë njohuritë e bmarra në nivelit e parë të studimeve në bachelor në financë Bankë.</p> <p>Ne lidhje me kete kriter GVJ konstaton se kurrikula e ketij PS, nuk permban praktike e cila do t'i shërbente trajnimit të mirëfilltë profesional te studenteve.</p> <p>Me mbarimin e programit, studentët kanë të drejtë të certifikohen sipas ligjit, në një profesion të rregulluar.</p> <p>Programi jep një bazë të qënësishme njohurishë edhe për studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve, në sistemin e doktoratës., pasi harmonizon trajtimin teorik dhe aplikativ, njohuritë bazike dhe të thelluara, me metodat e kërkimit dhe aftësimin për punë të pavarura dhe konceptin e analizës dhe mendimit analitik. Në aspektin e aftësive, programi zhvillon aftësi të specializuara për të zgjidhur problemet, qëndrim të pavarur, performancë të efektshme.për kërkim të aplikuar, për të zhvilluar procedura të reja.</p>
--	---

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>AU ofron disa diploma në nivelin e parë dhe të dytë në fushën e ekonomisë dhe financës në vecanti.</p> <p>Sejcili program dhe nivel ka objektiva, synime të diferencuara dhe përshkallëzuar dhe rjedhë dhe vazhdimësi logjike nga niveli i parë në të dytë dhe interferim dhe integrim midis lëndëve</p> <p>Përmbajtja e programit dhe njohuritë që ofron janë përshkallëzim i formimit të fituar nga studimet Bachelor.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve janë të vazhduara gjatë vitit dhe të fundme, me pjesën e aplikuar dhe me teste, por edhe me detyra apo punime kursi,me shkallë aktivizimi dhe frekuentimi por edhe peshë të dy testeve që janë të unifikuara në program përsa i përket peshës së tyre në vlerësimin përfundimtar. Kjo u konstatua nga verifikimi i syllabuseve gjatë vizitës në institucion nga GVJ. Studenti vlerësohet me 20 përqind për frekuentim dhe pjesmarrje aktive në seminare, 10 përqind për detyrat e kursit, 20 përqind në provimin e ndërmjetëm dhe 80 përqind në provimin përfundimtar. Lipset të forcohet kriteri frekuentim dhe angazhim aktiv, pasi sic u vertetua nga takimi me studentët kishte mangesi për t'u theksuar në këtë drejtim dhe që thujse nuk konsiderohej nga pedagogët.</p>
---	--


Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe</p>	<p>Bazë orientuese dhe për t'ju përmbajtur në hartimin dhe miratimin e planeve dhe programeve kanë qënë përvojat më të mira evropiane, vendore dhe kërkesat e Kartës së Bolonjës.</p> <p>Vetë strategjia e zhvillimit të institucionit përshkohet nga fryma e Kartës së Bolonjës, dhe është reflektuar në planin mësimor dhe fragmentimin e diplomave sipas niveleve, në mumurin e</p>
---	--

<p>procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>krediteve, në peshën e lëndëve sipas disiplinave karakterizuese, në ndërtimin e obhjektivave për nivelin bachelor dhe master i shkancave, në mobilitetin e studentëve, në mundësimin e transferimit të krediteve si në hyrje dhe në largime, në vazhvimësinë nga njohuri bazike në më të thelluara midis programit bachelor dhe master, në metodologjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, etj.</p> <p>Nëpërmjet programeve të ofruara synohet specialisti me aftësi konkurruese në tregun evropian të punës, njohja e diplomës, krediteve, etj.</p> <p>Programi është i konkurueshëm edhe jashtë AU, dhe në plan rajonal e evropian.</p>
---	---

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Ndërtimi i planit dhe programit mësimor të Msc Menaxhim Bankar, ka harmonizuar drejtë formimin bazë dhe të thelluar teorik me atë aplikativ e profesional. Kjo është realizuar midis lëndëve që ofron programi por edhe brenda cdo lënde.</p> <p>Në respekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi, janë respektuar raportet midis disiplinave të formimit të përgjithshëm me atë të thelluara të formimit profesional. Edhe brenda cdo lënde, synohet kombinimi formim teorik dhe aplikativ, kjo realizohet në trajtimin në leksione e seminare, detyra kursi, testet, etj.</p> <p>Krahas kësaj pjesë e angazhimit pedagogjik dhe studentor është edhe puna shkencore, që synon dhe kontribuon në këtë standart dhe objektiv formimi.</p> <p>Përmbushja e këtij standardi materializohet me: a) përcaktimin e tërësisë së aftësive dhe kompetencave profesionale dhe kërkimore që ofron programi, b) në përfshirjen në planin mësimor të praktikës, c) punimi e kursit apo edhe temën e diplomës me theks praktik dhe aplikativ; d) në organizimin e konferencave shkencore; në kryerjen e kërkimeve me sens aplikativ</p> <p>Konstatohet se PS Master i Shkencave ne Menaxhim Bankar, nuk përmban praktike që do të shërbente aftësimin profesional të studenteve.</p> <p>Programi respekton profilin e AU, strategjinë e tij, synimet dhe objektivat në plan afat mesëm dhe afat gjatë. Në mbështetje të këtyre objektivave, është rekrutuar e investuar në avancimin shkencor të stafit akademik, atij ndihmës, administrativ, etj. si dhe e gjithë infrastruktura e AU, që gjithsesi ofron një komoditet për t'u vlerësuar për mirë funksionimin e programit. Personeli akademik angazhohet në hartimin e kurrikulës, në vendimet institucionale për organizimin e programeve të studimeve, në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të përmirësimit të cilësisë. në zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit,</p> <p>GVJ sugjeron që institucioni të rrisë mbështetjen financiare për stafin akademik, për përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor, me qëllim që puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për</p>
---	--




	realizimin e programit të studimeve, te kete perputhshmeri me te larte me qellimet qe institucioni ka
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	N/A
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Synimi i programit është ofrimi i diplomave të vlefshme dhe kërkua në tregun e punës. Ata marrin njohuri të avancuara në fushat kryesore të menaxhimit bankar dhe financiar. Edhe rregullore e programit të studimit MSc në Menaxhim Bankar konfiguron këtë objektiv.
Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e prishëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Departamenti ka realizuar studimin e tregut të punës që sic e kemi nënvizuar edhe në komentet paaraardhëse <i>ka nevojë të jetë më i plotë dhe sidomos në drejtim të kërkesës që identifikohet në treg, sektorëve ku synohet, konkurentëve dhe sidomos edhe praktikave të konkurimit dhe niveli i suksess për të diplomuarit në këtë program.</i>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;	Nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive, programi Msc Menaxhim Bankar mbështet dhe i kultivon interesat dhe vlerat kombëtare
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Ruajtja e vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian etj janë këto ndër objektivat cilësorë të programit dhe të gjithë strategjisë së zhvillimit të AU.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Bankar përmban 120 kredite, 2 vite akademike nga 60 kredite cdo vit dhe 38 kredite për punimin e diplomës. <i>Duke vlerësuar fushën e gjërë që i adresohet programi në treg, sektorin financiar, biznesin privat, sektorin publik dhe jo publik, etj, kërkohet të ketë më shumë hapsirë për kredite në lëndë të adresuara në këto fusha. Nga ana tjetër, niveli në hyrje dhe dalje i studentëve, niveli i zotërimit të gjuhës së huaj, mundësitë dhe ngarkesat e tjera të PAE dhe PAK për të drejtuar cilësisht deri 5 diploma kushtëzojnë që numuri krediteve për punimin e diplomës</i>

	<i>të jetë disi më i ulët.</i>
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	N/A
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	N/A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Studentët informohen cdo fillim viti, mbi kalendarin akademik, programin mësimor, lëndët që do të zhvillojnë, pedagogët përgjegjës, orarin, ambientet ku do të zhvillohet mësimi dhe mbi programet e studimeve vihen në dispozicion të studentëve në manifestin akademik, në ambientet e universitetit, dhe në faqen <i>web</i> të universitetit (http://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-shkencave-ekonomike/). Ata njihen me rregulloren mësimore, praktikat dhe diplomat, si elementë të mbarëvajtjes së programit.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Sic u verifikua në institucion dhe relatohet edhe nga RVB, për finalizimin e procesit të diplomimit, njësia bazë dhe kryesore kanë hartuar dhe miratuar rregullore të programit të studimit MSc në Menaxhim Bankar, dhe rregullore e punimit të diplomës Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur Punimin e Diplomës pajiset me diplomën “Master i Shkencave në Menaxhim Bankar” të shoqëruar me listën e notave të fituara si dhe me suplementin e diplomës. Dorëzimi i diplomave realizohet me një event të veçantë enkas për studentët e diplomuar.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Programi i studimit ‘Master i Shkencave në Menaxhim Bankar’ është në përputhje me misionin dhe qëllimin e AU. Programi në zbatim edhe të kriterëve të Kartës së Bolonjës, është iniveli të dytë dhe kombinon në mënyrën e kompozimit të tij aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor. Plani mësimor dhe syllabuset e programit konsiderojnë njohuritë bazë të marra në nivelin bachelor për disiplinat e formimit bazë dhe karakterizues.</p> <p>Programi sipas objektivave dhe misionit synon edhe tregun ndërkombëtar e rajonal vecas, ai ka kredite të transferueshme dhe nga pikpamja e lëndëve dhe syllabuseve, i konvertueshëm.</p> <p>Mbështetur në udhëzimet e MASR, programi është i organizuar me 120 kredite në katër simestra, me nga 30 kredite cdo semestër. Programi i studimeve merr parasysh nevojat e tregut të punës ndonse GVJ ka rezerva për cilësinë e studimit të tregut të punës në fushat që synohet të mbulojë programi.</p> <p>Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve. Informacioni</p>	

mbi programin dhe çështje të aksesimit të tij nga studenti, është transparent, i disponueshëm në faqet e internetit, por edhe nga strukturat ndihmëse dhe administrative të AU.

Konstatohet se PS Master i Shkencave në Menaxhim Bankar, nuk përmban praktike që do të shërbente aftësimin profesional të studenteve.

Programi Msc Menaxhim Bankar, si program i ciklit përmbillet me punimin dhe mbrojtjen e diplomës që është rregulluar me një rregullore të programi nga njësia bazë. Cilësia e diplomave, shkalla e argumentit, modelimi dhe strukturimi sipas koncepteve të metodave të kërkimit dhe shkrimit akademik, mbetet sfida për të ardhmen.

GVJ vlerëson se standardet përmbushen kryesisht

Rekomandime:

- Studimi i tregut ka nevojë të jetë më i plotë dhe sidomos në drejtim të kërkesës që identifikohet në treg, sektorëve ku synohet, konkurrentëve dhe sidomos edhe praktikave të konkurimit për të diplomuarit në këtë program dhe niveli i suksesit të tyre..
- Duke vlerësuar fushën e gjërë që i adresohet programi në treg, sektorin financiar, biznesin privat, sektorin publik dhe jo publik, etj, kërkohet të ketë më shumë hapsirë për kreditë në lëndë të adresuara në këto fusha
- GVJ sugjeron që institucioni të rrisë mbështetjen financiare për stafin akademik, për përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor, me qëllim që puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve, të ketë përputhshmeri me të lartë me qëllimet që institucioni ka
- Meqënëse është master në fushën e bankave por edhe të sistemit financiar, rekomandojmë që lëndët të orientohen më shumë çështje që lidhen me këta sektorë (shih në raportin më lart)

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia konsiderohet element kyç i cilësisë së produktit, diplomës që ofron programi Msc Menaxhim Bankar. Në funksion të saj janë ndërtuar strategji, hartuar rregullore të të gjitha niveleve dhe orientohet puna e njësisë kryesor, bazë dhe të programit. etodat kryesore të mësimdhënies janë metodat interaktive, ku në qendër të mësimdhënies është studenti. Synimi është nxitja e të menduarit kritik, analitik, aftësimi për të punuar në grupe, kërkim shkencor dhe punë të pavarur, etj.

Mësimdhënia realizohet me leksionet, seminarët/ushtrimet, detyrat e kursit, projekte, etj; në 15 lende.14 provime dhe punimi i diplomës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Procesi i mësimdhënies zbatohet sipas syllabusit të çdo lënde dhe në liri të plotë të personelit akademik. Ngarkesa mësimore në leksione e seminare për studentët realizohet sipas udhëzimeve të nga MASR.

Personeli akademik përdor mjetet didaktike si raste studimore, slide, tekste shtesë, urdhëresa e botime ligjore sipas rastit si dhe teknologjinë në auditore PC dhe Video-projektorë. Për detyrimet vjetore hartohet proces verbal paraprak, me shkallën e realizimit të detyrimeve vjetore nga studenti. E gjithë procedura e mësimdhënies deri tek vlerësimi përfundimtar trajtohet në rregulloren mësimore të programit të studimit.

Nga verifikimi në sekretarinë mësimore, në departament, dhe sipas RVB, provimi rezulton i sekretuar. Në politikën e universitetit e përmendur kjo edhe në rregulloren e universitetit nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, pra studenti vlerësohet gjatë semestrit provimit përfundimtar në sezon. Formula e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë paraqitet në syllabusin e lëndës (Tabela 15).

Departamenti dhe NJSBC në kuadrin e vlerësimit të cilësisë monitorojnë procesin në të gjithë komponentët, nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme. Nga çdo pedagog dhe departamentit hartohet raport semestral për cilësinë e mësimdhënies.

Krahas mësimdhënies dhe mësinxënëies, studentët dhe personeli akademik, janë angazhuar në punime të përbashkëta, me pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare organizuara nga njësia kryesore, fakulteti. Në to marrin pjesë përfaqësues të studentëve, po ashtu ata përfaqësohen nëpërmjet Këshillit Studentor dhe në Senatin Akademik.

Sic u relatua më sipër ka ardhur në rritje aktivizimi dhe bashkëpunimi në punë shkencore midis studentëve dhe pedagogëve që në mënyrë të përmbledhur për vitin e fundit akademik sipas RVB dhe anekseve që e shoqërojnë paraqitet në Tabelën 16.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi në programin master i Shkencave në Menaxhim Bankar, është realizuar sipasmbështetur në Ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi, mbi rregulloren e programit dhe rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve.

Kandidati plotëson formularin e aplikimit për programin me dokumentacionin përkatës. Përzgjedhja bëhet sipas rregulloreve të organizimit të programit, rregulloreve të regjistrimeve dhe transferimeve. Vendimi merret nga autoritetet drejtuese të njësisë kryesore.

Në Tabelën 17 në Aneks (marrë nga të dhënat e RVB dhe vizitës në sekretari) rezulton se:

- Në vitin akademik 2012 – 2013 u regjistruan 48 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.16;
- në vitin akademik 2013 – 2014 u regjistruan 59 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.2 dhe 1 student i transferuar në vitin e dytë;
- në vitin akademik 2014 – 2015 u regjistruan 56 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.23 dhe 1 student i transferuar në vitin e dytë;
- në vitin akademik 2015 – 2016 u regjistruan 32 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.2;
- në vitin akademik 2016 – 2017 u regjistruan 6 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.46 dhe 9 studentë të transferuar në vitin e dytë;
- në vitin akademik 2017 – 2018 u regjistruan 10 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.97, dhe 3 studentë të transferuar në vitin e dytë;

Vihet re një ulje drastike e numrit të të rregjistruarve për herë të parë, ku sipas vizitës në institucion sillet argument kriteri i gjuhës së huaj anglisht si kriter pranimi. Edhe shifrat e mësipërme tregojnë se ende tregu është i paqartë e duhet bërë studim shumëplanësh i tij, dhe ka mjaft arsye të tjera, që duhen marrë në konsideratë për mbarëvajtjen e programit dhe të të gjitha programeve të studimit.

I njefti fenomen është i pranishëm edhe në programin Master i Shkencave në “Administrim Biznes”

Një tregues i mirë është rritja e mesatares hyrëse të studentëve.

Programi ka afat ligjor maksimal mbarimi 4 vite akademike, pra dyfishi kohës së rregullt, porveç kur studenti ka pezulluar studimet. Studenti mund të vijojë pjesëmarrjen në program mbi kohën e rregullt të studimeve, kur shlyen detyrimet sipas planit mësimor dhe paguan tarifat përkatëse.

Sipas Rregullores së Programit, për kalimin në vitin pasardhës, është vendosur kriteri i 50 % të krediteve të fituara të vitit paraardhës. Lëndët të cilave u përkasin kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura. Kushtet dhe rendin e shlyerjes së detyrimeve të mbartura për fitimin e krediteve të mbetura i cakton Departamenti i Shkencave Ekonomike, në zbatim të rregullores së Fakultetit.

Rregullorja e programit, por edhe syllabuset e cdo lende kanë të përcaktuara detyrimet e frekuentimit dhe penalizimet në rastin me 25 % mungesa, me 50 përqind dhe mbi 50 përqind, studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lende kur ka kryer më shumë së 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lende. Në qoftë se ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës atëherë ai pranohet në sesionin e dytë. Nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë. Informacioni mbi programin disponohet dhe është lehtësisht i aksesueshëm për studentin në Zyren e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve, në departament. Për mundësitë e punësimit gjithashtu mbahen kontakte dhe kërkohet informacion nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Për të ndjekur programin e studimit MSc në Menaxhim Bankar çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor apo ekuivalente;
2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë;
3. Të plotësojë kriteret e përcaktuara nga udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Nuk është vendosur kriter pranimi nota mesatare dhe kjo për arsye pragmatiste, tregu. Ndonse numri i të rregjistruarve për herë të parë ka rënie të dukshme ka një rritje të lehtë nota mesatare në hyrja, nga 6.16 vitin e parë të programit në 6.97 vitin 2017-2018. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve paraqitet në Tabelën 17.

Nga fillimi i programit janë diplomuar 219 vetë nga të cilët 55 përqind rezultojnë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 15 përqind të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Rregullorja e programit MSc në Menaxhim Bankar parashikon rregullat për politikën e kriteret dhe dokumentacionin e pranimi dhe procedurat e përzgjedhjes.</p> <p>Pranimi i studentëve në orgramin Msc Menaxhim Bankar bëhet mbi diplomën bachelor ose diplomë ekuivalente, me 180 kredite ECTS.</p>

<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të percaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, sic mund të ishte nota mesatare në hyrje.</p> <p>Nga viti 2012 deri 2015 gjatë viteve të studimit studenti ka dhënë provimin e njëjës nga pesë gjuhët evropiane me test të njohur ndërkombëtar sipas përcaktimit të MASR,</p> <p>Nga viti 2015 e në vazhdim gjuha e huaj është kriter hyrës. Politikat e pranimit nuk kanë ndryshuar ndonjëherë nga institucioni janë analizuar herë pas here.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në periudhën e regjistrimit njësi bazë angazhohet për informimin për programin e studimit, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të krediteve, akreditimin e programit ku ata aplikojnë, etj. Po ashtu funksionojnë në mënyrë permanente Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve (ZKMS) për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) për lidhjen e studentëve me komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës. Studentëve informacion për mundësi punësimi në përfundim të programit. Në njëleksion të hapur në përfundim të vitit të dytë u vihet në dispozicion “Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës.</p> <p>Nëpërmjet Manualit të Studentit. ZKMS vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese për t’i orientuar ata për të njohur organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre.[]</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Sic u relatua në pjesën përshkrimore dhe në anekset në fund të raportit AU ka të dhëna mbi numrin e të regjistruarve, transferuarve dhe të larguarve nga programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomim.</p> <p>Ka Regjistër Themeltar (Regjistri i Matrikullës), Regjistri i Rezultateve Akademike, Regjistri i Diplomave. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Ka një rregullore për organizimin e strukturave që menaxhojnë të dhënat e mësipërme.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>Institucioni dhe programi kanë të dhëna për punësimin e studentëve pas përfundimit të programit.</p> <p>Rreth 90% e studentëve që ndjekin studimet janë të punësuar</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>dhe ata ndjekin studimet për t'u kualifikuar më tej, për të siguruar një vend pune në administratën shtetërore ku diploma "Master i Shkencave" është domosdoshmëri, për të qenë të suksesshëm në karrierën e tyre dhe për të ruajtur vendin e punës.</p> <p>Në përmbushjen e këtij standardi ZKA përmes organizimit të aktiviteteve me studentët e diplomuar kontribuon duke shpërndarë informacione mbi ofertat e tregut të punës, mundësinë e praktikave.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>AU ka organizuar informimin e studentëve për programin në disa forma. Studentët informohen nga pedagogët, fletëpalosjet, broshurat, nga faqja e internetit të universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/)</p> <p>Në vazhdimësi studenti informohet për detyrimet e cdo lende dhe detaje të tjera për mbarëvajtjen e cdo lende dhe të programit, me detyrimet dhe të drejtat e tij, etj.</p> <p>Pedagogu i lëndës, përgjegjësi i modulit/lëndës diskuton rezultatet e vlerësimit, sqaron pikat e forta dhe të dobëta të detyrës/provimit të kryer.</p> <p>Në raste kontestimesh bëhet edhe ballafaqimin student-pedagog sipas Rregullores së Programit Msc Menaxhim Bankar.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Për studentët me probleme përvetësimi programi, dhe për detyrime të prapambetura, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.</p> <p>Me mbështetjen e ZKMS, Departamenti orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit për praktikën mësimore. sipas marëveshjeve të AU me institucionet.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mesimore, konstatoi se në rregjistrin e lendeve kishte mangësi në plotësimin e mungesave, ku vihej re se në lende të caktuara, gjatë pjesës me të madhe të semestrit nuk kishte mungesa të identifikuar.</p> <p>GVJ sugjeron vendosjen e një kufiri minimal për mesataren e pranimit në Msc në Menaxhim Bankar, me qëllim orientimin drejt rregjistrimit të studentëve me cilësori të hyrje.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>GVJ konstaton se AU ka një dokumentacion të plotë për informimin në procesin e pranimit, të vazhdimësisë së programit, të praktikave mësimore dhe të punësimit.</p> <p>Ka struktura permanente krahas departamentit që ndjekin këtë problem dhe informimi dhe ndihma e studentit është pjesë organike e punës së departamentit të shkencave ekonomike dhe të cdo pedagogu gjatë zhvillimit të lëndës. AU garanton cilësinë e informimit të studentëve, për vlefshmërinë e diplomës, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të krediteve në Universitete të tjera vendase dhe të huaja</p>	

etj.

Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin dhe studentët e diplomuar dhe përpiket për të gjurmuar studentët e diplomuar.

Vihet re një ulje drastike e numrit të të rregjistruarve për herë të parë, ku sipas vizitës në institucion sillet argument kriteri i gjuhës së huaj anglisht si kriter pranimi. Edhe shifrat e mësipërme tregojnë se ende tregu është i paqartë e duhet bërë studim shumëplanësh i tij, dhe ka mjaft arsye të tjera që duhen marrë në konsideratë për mbarëvajtjen e programit dhe të të gjitha programeve të studimit.

GVJ konstaton se Departamenti dhe stafi i programit vecanërisht ofrojnë ndihme e përkushtim për studentëvt me probleme realizimi programi me konsultimi, me seanca speciale, shtojcë, dhe i garantojnë studentit transparencë në vlerësimin e provimeve dhe të gjithë progresin e tyre në procesin mësimor, në praktikën profesionale dhe në përgatitjen e diplomës.

GVJ shprehet se standardet përmbushen kryesisht

Rekomandime:

- GVJ sugjeron vendosjen e nje kufiri minimal per mesataren e pranimi ne Msc.ne Menaxhim Bankar, me qellim orientimin drejt rregjistrimit te studenteve me cilesor ne hyrje
- GVJ mbi bazën e vizitës në sekretarinë mësimore dhe komunikimit me studentët rekomandon zbatimin e rregullores mbi frekuentimin, evidentimin e tij te sakte, marrjen parasysht ne komponentet e vlerësimit.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Pjesë integrale e procesit mësimor, e kualifikimit dhe progresit të pedagogut dhe e jetës akademike në departament, fakultet dhe institucion është kërkimi shkencor dhe puna shkencore në përgjithsi.

Në AU ajo është pjesë e strategjisë zhvillimit, e rregulloreve dhe strukturave përkatëse për organizim dhe ndjekje. Ashtu si procesi i mirëfilltë mësimor, edhe ajo mbështetet në ligjin 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Kërkimi, miratohet nga senati i AU, mbështetet nga strukturat në shkallë institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë.

Puna shkencore konsiston në drejtime kryesore si: kërkim bazë ose të aplikuar; studime dhe projekte për zhvillim; veprimtari të tjera krijuese me objektiva specifike të institucionit; në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij; në procesin akademik me programe, teori dhe praktika sipas Kartës së Bolonjës. Synohet përmirësim i raportit punë mësimore dhe shkencore, përfshirja dhe angazhimi i studentëve në veprimtari e kerkime shkencore, mbështetja institucionale.

AU ka si struktura për punën shkencore, Zv. Rektorin për Kërkim Shkencor; AU realizon botime akademike. Në të funksionon Zyra e Kërkimit Shkencor dhe e Botimeve Akademike, ka një pozicion të

dedikuar për kërkimin shkencor- Zv/Rektorin për Kërkimin Shkencor, i cili synon koordinimin e gjithë hallkave për Kërkimin Shkencor dhe Botimet.

Këto janë sanksionuar në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Albanian University.

Sipas RVB dhe vizitës në institucion, kërkimi shkencor është fokusuar në punët individuale të pedagogëve në këto drejtime kryesore:

1. Kualifikimin e pedagogëve të brendshëm për marrjen e gradës Dr. në shkencat ekonomike;
2. Përgatitjen e teksteve bazë, për të siguruar cilësi më të lartë;
3. Studime dhe botime në revista shkencore brenda e jashtë vendit;
4. Pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Çdo vit njësia kryesore organizon Konferencën Ndërkombëtare me temë "Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standardeve të Bashkimit Europian" në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universiteti La Sapienza, Romë dhe Konferencën Studentore me temë "Zhvillimi i qëndrueshëm"

Departamenti realizon gjatë viti akademik aktivitete të shumta ekstrakurrikulare me tema dhe të ftuar në shërbim të profileve të programeve që implementon.

Departamenti ka fituar një Erasmus+ me Kolegjin Powislanski në Poloni, nga e cila ka përfituar mobilitet 1 student nga AU dhe 4 pedagogë nga Kolegji Powislanski

Departamenti gjatë vitit akademik 2017-2018 ka realizuar aplikime në 4 projekte :

1. Spreading Excellence and Widening Participation – part of H2020;
2. H2020-MSCA-NIGHT-2018;
3. International open innovation center applying Triple Helix Model: Academia, Government, and Industry;
4. EACEA Programme "Europe for Citizens": Democratic engagement and civic participation.

Institucioni është pjesë e projektit "GRADUA" (Erasmus + CBHE) ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë. GRADUA ka filluar të implementohet në muajin tetor 2017 dhe do të vazhdojë deri në muajin tetor të vitit 2020.

GVJ sugjeron që institucioni duhet të sigurojë mekanizmat që do të nxisin pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studenteve të programit master i Shkencave në Menaxhim Bankar në projekte të ndryshme shkencore, si dhe në botime shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare me faktor impakti

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Vitin e fundit AU ku bën pjesë dhe Departamenti i Shkencave ekonomike, ka realizuar në total si institucion dhe në mënyrë individuale aktivitete shkencore.

Krahasuar me kohën e akreditimit të parë të Programit Msc Menaxhim Bankar, është rritur pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, në trajnimin shkencor jashtë vendit, mobiliteti i studentëve infrastruktura në kërkimin shkencor, pjesëmarrja në aktivitete shkencore jashtë AU dhe jashtë vendit, numri i cmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, etj. (Tabela 19 në aneks). Por për programin Msc në Menaxhim Bankar nuk ka të dhëna konkrete.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Pedagogët kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Departamenti përgjegjës për programin Msc Menaxhim Bankar inkurajon, ndjek dhe evidenton kërkimin shkencor të stafit të programit. Në raportin e veprimtarisë ekstrakurikulare dhe shkencore periudha 2012-2017 praqitet aktiviteti shkencor i cdo PAE dhe PAK të programit.</p> <p>AU publikon revistën periodike "Optime", me artikuj shkencorë të pedagogëve të institucionit, por dhe të studiuesve jashtë AU.</p> <p>Ka pedagogë autorë tekstesh universitare, të shkollave të mesme, etj.</p> <p>Për personelin e ri akademik, në proces kualifikimi vihen detyrime specifike shkencore dhe mbështeten në publikimet apo kërkimet individuale.</p> <p>Personeli Akademik paraqet cdo vit Formularin e Kërkimit Shkencor, me arritjet dhe angazhimet akademike, sipas Formularit Model të Kërkimit Shkencor të pedagogut.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Pjesë të personelit të AU janë angazhuar edhe në mësimdhënie në gjuhë të huaj edhe në universitete jashtë vendit.</p> <p>Sipas RVB dhe konstatimit në institucion, AU nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj, dhe nuk ka pedagogë të këtij fakulteti që të angazhohen në mësimdhënie në gjuhë të huaj për një semestër apo edhe më shumë.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjeshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjeshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Sipas RVB, dhe evidentimit të AU për trajnime stafi të brendshme janë organizuar disa trajnime për zhvillimin profesional të personelit akademik në fushën e mësimdhënies me objekt përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore, për specifikat e mësimdhënies me të rriturit, për këshillimin e karrierës, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të arsimit të lartë, etj.</p> <p>Personeli akademik i AU është mbështetur për kualifikime të mëtjeshme brenda ose jashtë vendit. Disa pedagogët e brendshëm janë financuar nga Universiteti në realizimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore. <i>Mungojnë në këtë listë pedagogët e Departamentit të Shkencave Ekonomike.</i></p> <p><i>Departamenti i Shkencave Ekonomike në kuadër të institucionit kërkohet të rrisë punën në aplikime projektesh</i></p>

	<p><i>individuale dhe si departament në plan lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe nga ana e tij Autë shokë mundësinë e rritjes së mbështetjes institucionale administrative, ligjore dhe financiare</i></p> <p>Për mundësitë e aplikimit në programe kualifikimi ndihmon edhe Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, që informon për pedagogët e stafin dhe ofron konsulencë për aplikimin në këto programe.</p> <p>GVJ konstaton nga informacioni i vendosur ne dispozicion nga institucioni, se mbështetja financiare nga institucioni ka ekzistuar, por konsiderohet ne nivele relativisht te ulta. Per sa me sipër GVJ sugjeron intensifikimin e mbështetjes financiare ndaj stafit akademik per pjesëmarrjen e tyre ne aktivite shkencore dhe trajnime si dhe vendosjen e nje sistemi pikëzimi dhe bonusesh per stafin akademik, per te matur kontributin e tyre por edhe per ti motivuar ata.</p>
--	--

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni evidenton punën shkencore, borimet e kërkimet disponohen të dhëna për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit Master.</p> <p>Përgatitet Raport i detajuar për aktivitetet shkencore, botimet dhe trajnimet e pedagogëve ku rezulton se pedagogët janë të përfshirë në disa projekte kërkimore-shkencore individualisht dhe ne nje program si pjesë e departamentit.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstaton se puna shkencore në AU në kharasim me kohën e akreditimit të parë të programit Msc Menaxhim Bankar, ka shënuar rezultate dhe përmirësime në aspektin institucional, mbështetjes dhe ndjekjes me struktura administrative dhe shkencore, në planifikimin dhe koordinimin e saj, problematikën e trajtuar, larminë e punës shkencore, etj.

Eshte rritur prezenca individuale dhe institucionale e AU dhe stafit të tij në publikime, konferenca, pjesmarrje në projekte, angazhime të studentëve, etj.

AU publikon revistën periodike "Optime" dy herë në vit, e cila përmban artikuj shkencorë të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU.

AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master.

Funksionon në mënyrë permanente Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike

Ekspteri shprehet se standardet përmbushen kryesisht

Rekomandime:

- GVJ rekomandon rritjen e mbështetjes financiare ndaj stafit akademik për pjesëmarrjen e tyre në aktivite shkencore dhe trajnime si dhe vendosjen e një sistemi pikëzimi dhe bonusesh për stafin

akademik, për të matur kontributin e tyre por edhe për ti motivuar ata.

- Departamenti i Shkencave Ekonomike në kuadër të institucionit kërkohet të rrisë punën në aplikime projektsh individuale dhe si departament në plan lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe AU të shohë mundësinë e rritjes së mbështetjes institucionale administrative, ligjore dhe financiare të punës shkencore, trainimeve dhe kualifikimeve shkencore, pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare apo edhe projekte shkencore.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Universiteti dhe Fakulteti ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete dhe organizata të huaja dhe shqiptare si: Universitetin Ningbo, Universitetin Powislanski, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Kolegjin Qiriazi, Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike etj. Më konkretisht këto bashkëpunime kanë synuar në:

- Konferenca të përbashkëta dhe programe kulturore;
- Shkëmbime të materialeve akademike, botimeve dhe dokumentacioneve të tjera;
- Shkëmbimin e pedagogëve, kërkimeve shkencore, personelit administrativ dhe teknik;
- Shkëmbimin e studentëve;
- Projekte të përbashkëta kërkimore.

Në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore të studentëve, Fakulteti ka arritur bashkëpunime me 22 institucione dhe biznese të ndryshme me të cilët ruan edhe kontakte të vlefshme në kuadër të studimit të tregut të punës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

AU ka marrë spesë si partner në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, në trajnime, kërkime shkencore, në aktivitete shkencore jashtë vendit, etj. (Tabela 20 në aneks).

Po ashtu evidentohen edhe institucionet dhe organizatat ashkëpunuese, për praktikën mësimore, dhe universitete apo institucione për projekte, evente, shkëmbime stafi etj. AU ka marrëveshje bashkëpunimi me 7 universitete dhe 24 biznese dhe institucione. (Tabela 21 në anekse).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	AU ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të përmendura më lart si Universiteti Ningbo, Universiteti Bujqësor i Tiranës etj.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi	Institucioni ka vendosur bashkëpunim me biznese apo institucione për realizimin e praktikës për studentët e viteve të fundit si Union Financiar Tiranë sh.a., ACER, IDRA, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Dhoma e Tregtisë dhe

<p>me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitim të njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Industrië Tiranë, etj. Çdo vit organizohet edhe Panairi i Karrierës ku ftohen biznese dhe kompani të shumta.</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Për mbarëvajtjen e programeve të studimit në kuadër të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. Strukturat administrative dhe akademike të insttë gjitha strukturat bashkëpunojnë. Secila zyrë raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e kryer në instancat nga të cilat varet, duke garantuar transparencë dhe bashkëpunim të frytshëm midis strukturave të institucionit</p> <p>Në rregulloren e fakultetit dhe rregulloren e departamentit, janë përcaktuar detyrat e stafit.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
